

Historia e arrestuarve dhe të mbijetuarve shqiptarë në kampin famëkeq të Mauthausenit në Austri

Nga Dorian Koçi, historian

10/13/2021



Contents

Ardhja e nazizmit në pushtet në Gjermani. Aparati i dhunës. Kampet e Përqëndrimit	2
Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore dhe pushtimi gjerman në Shqipëri	6
Arrestimet, deportimet në Mauthausen. Kampi i Mauthausen-it (1938-1945)	18
Vlora	19
Durrësi	22
Kampi i Mauthausen-it	26
Nënkampin i Gusenit	31
Nënkampi Ebesen	32
Nën kampin i Melkut	32
Nënkampin i Buhensvaldit	32
Çlirimi i Kampit Mauthausen	32
Kthimi i të mbijetuarve	34
Rehabilitimi në shoqërinë totalitare komuniste	42
Përfundime	54

Ardhja e nazizmit në pushtet në Gjermani. Aparati i dhunës. Kampet e Përqëndrimit

Lufta e Dytë Botërore është cilësuar si lufta më shkatërrimtare e njerëzimit , si lufta me humbjet më të mëdha njerëzore. *Që nga shek. i XVII asnjë luftë në Europë nuk kishte qënë kaq mizore dhe me kaq shumë shkatërrime. Tani paqja ishte rikthyer, por shumë e kuptuan sikundër poeti në fund të Luftës Tridhjetvjeçare, se ajo ishte paqe e ngritur mbi një varrezë.*¹ Kjo varrezë njerëzore nuk u shkaktua nga njerëz që u shndrruan në kriminelë brenda ditës por ishte rezultat i dhunës së një aparati të sofistikuar represiv mbi qëniet njerëzore. Nazizmi gjerman si ideologjia që lindi përmes të ashtëquajturit revolucion racial që promovonte “diferencat nga natyra” – superiorët mbi të tjerët dhe darvinizmin social, shkaktoi humbjet më të mëdha njerëzore në histori. Rreth 75 milion njerëz vdiqën në Luftën e Dytë Botërore, përfshirë rreth 20 milion personel ushtarak dhe 40 milion civilë, shumë prej të cilëve vdiqën për shkak të gjenocidit të qëllimshëm, masakrave, bombardimeve masive, sëmundjeve dhe urisë. Lufta e Dytë Botërore ishte një luftë religjioni , apo në terma modern, lufta e ideologjive nga të dyja anët. Ajo qe gjithashtu , edhe këtu faktet flasin vetë, një luftë për jetë a vdekje me shumicën e vendeve pjesëmarrëse. Çmimi i disfatës përballë regjimit nacional-socialist gjerman , siç u vërtetua në Poloni e në pjesën e pushtuar të Bashkimit Sovjetik dhe me fatin e hebrenjve , zhdukja sistematike e të cilëve iu bë e njohur shkallë shkallë një bote mosbesuese, ishte skllavërimi dhe vdekja. Prandaj lufta nuk njohu kufi. ²

Ardhja në pushtet e Adolf Hitlerit dhe nazizmit në Gjermani në 30 janar 1933 shënon fillimin e instalimit të aparatit hitlerian të dhunës. Menjëherë pas ardhjen në pushtet në vitin 1933, Hitleri urdhëroi një riorganizim të gjithë institucioneve shtetërore. Në këtë kuadër, drejtuesi i forcave SS, ristrukturoi forcat e policisë gjermane, të cilat ishin nën komandën e “Drejtuesit të Rajhut SS dhe Shefit të Policisë”, Heinrich Himmler, i cili e kishte zyrën në Berlin dhe përgjigjej para Hitler-it për rendin dhe qetësinë në gjithë Gjermaninë. Për të realizuar këtë detyrë, Himmler-i krijoi dy zyra qendrore, Zyrën Qendrore SS dhe Zyrën Qendrore për Sigurinë. Zyra Qendrore SS duhej të merrej me riorganizimin e formacioneve të Armës-SS. Nazistët shpallën gjendjen e jashtëzakonshme në Gjermani vetëm disa javë pasi erdhën në pushtet, nëpërmjet një dekreti të posaçëm – “Dekreti për Mbrojtjen e Popullit dhe të Shtetit” (Verordnung zum Schutz von Volk und Staat) – i cili efektivisht mbeti në fuqi deri në

¹Uolltër Lakër, *Europa në Kohën Tonë 1945-1992* , Dituria , Tiranë: 2003, fq. 22

²Erik Hobsbaëm. *Epoka e ekstremeve*.Çabej, Tiranë, 1994, fq 45.

përfundim të Rajhut të Tretë. Qysh në krye, internimi i kundërshtarëve politikë dhe i hebrenjve në kampet e përqendrimit nuk u arrit mbi bazat e ligjit të zakonshëm, por nëpërmjet një instrumenti ligjor të posaçëm (Schutzhaft) i cili e kishte origjinën në ligjin prusian të 4 qershorit 1851 mbi shtetrrëhimin, por që edhe më pas – gjatë Luftës së Parë Botërore si dhe gjatë Republikës së Weimar-it (1918-1933) – ishte shfrytëzuar në kontekstin e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme. Schutzhaft i lejonte autoritetet naziste, specifikisht Gestapo-n (Geheime Staatspolizei), që në emër të parandalimit të veprimtarive që mund të kërcënonin sigurinë e shtetit, ata të ndalonin dhe të arrestonin edhe persona që nuk kishin kryer asnjë vepër kriminale.

Gjatë krijimit të formacioneve SS u morën masa që ushtarët që rekrutoheshin të zgjidheshin me kujdes. Kushtet kryesore ishin fanatizmi politik, të kishin një gjatësi trupore prej të paktën 1.80 metër, të ishin me sy bojë qielli dhe flokëverdhtë. Sipas botëkuptimit nacionalsocialist, këto trupa duhej të ishin elita e ushtrisë gjermane dhe nëse ishte nevoja, të hapnin zjarr edhe kundër popullit të tyre, nëse do të rrezikohej diktatura naziste që po instalohesh në Gjermani. Në fillim të luftës së dytë botërore trupat e Armës-SS nuk u përdorën për luftime në vijë të parë të frontit, por ato futeshin menjëherë në terrenet e sapo pushtuara, për t'i mbajtur ato nën kontroll. Për herë të parë trupat SS u përdorën për luftime frontale në sulmin ndaj Bashkimit Sovjetik dhe në Ballkan, ku ishin krijuar formacione të fuqishme partizane, të cilat vlerësoheshin si formacione fanatike politike.³

Ndërsa organizimi i SS u bë hapur organizimi i policisë së fshehtë për të goditur kundërshtarët politikë u krye në mënyrë të fshehtë. Policia e fshehtë naziste ishte me emërtimin Zyra Qendrore për Sigurinë. Shefi i kësaj zyre ishte Ernst Kaltenbrunner me prirje të forta nacionalsocialiste. Kaltenbrunner-i ishte edhe shefi i Gestapo-s, e cila ishte organi më i rëndësishëm i diktaturës nacionalsocialiste që kishte për detyrë të zbulonte dhe asgjësonte çdo qëndresë politike ndaj regjimit dhe të garantonte sigurinë e institucioneve të reja shtetërore. Për këtë qëllim u krijua Zyra e Shërbimit të Brendshëm SD, me seli në Berlin. Prej këtu organizohej kontrolli dhe survejimi i gjithë njerëzve, sidomos i kundërshtarëve politikë, të cilët pakësoheshin dita ditës dhe ndonëse nuk bënë asnjë shkelje ligjore dërgoheshin në kampe përqendrimi ose ekzekutoheshin në masë, duke u përdorur gjithë mënyrat e rafinuara që ofronte asokohe shkenca dhe teknologjia. Për të zbuluar kundërshtarët politikë u krijuan Komandat Vendore SD, të cilat ishin vendosur në çdo qytet të madh dhe informoheshin nga

³Marenglen Kasmi.

njerëzit e besuar, pra agjentët, për aktivitetet politike të qytetarëve. Këto organe represive arritën që brenda një kohe të shkurtër të mbillin psikozën e frikës dhe pasigurisë dhe të thyenin kështu qëndresën e brendshme të popullit gjerman.⁴ Një aspekt tjetër i instalimit të diktaturës hitleriane ishte manipulimi i masave ndërmjet një rrjeti të sofistikuar propagande të udhëhequr nga nazisti i orëve të para Jozef Gëlbels. Në vendet totalitare propaganda dhe terrori paraqet dy anë të së njëjtës monedhe. Kudo që totalitarizmi zotëron kontroll absolut, ai zëvendëson propagandën me indoktrinimin dhe e përdor dhunën jo aq sa për të frikësuar njerëzit, sesa për të realizuar vazhdimisht doktrinat e tij ideologjike dhe gënjeshttrat e tij praktike.⁵

Një nga mjetet e para e ushtrimit të terrorit ishin hapjet e kampeve të përqendrimit⁶, fillimisht në territorin gjerman dhe më vonë dhe në territoret e pushtuara. Autoritetet naziste gjermane krijuan kampe në të gjithë Gjermaninë në baza ad hoc për të trajtuar masat e njerëzve të arrestuar si subversivë të dyshuar. SS -të krijuan kampe më të mëdha në Oranienburg, në veri të Berlinit; Esterëegen, pranë Hamburgut; Dachau, në veriperëndim të Mynihut; dhe Lichtenburg, në Saksoni. Në vetë Berlinin, objekti Columbia Haus mbante të burgosurit nën hetim nga Gestapo (policia sekrete gjermane e shtetit) deri në vitin 1936. Kampet e përqendrimit, ndryshe nga burgjet, ishin të pavarura nga çdo rishikim gjyqësor. Kampet e përqendrimit nazist shërbenin për tre qëllime kryesore:

- 1- Për të burgosur njerëzit të cilët regjimi nazist i konsideronte si një kërcënim për sigurinë. Këta njerëz u burgosën për një kohë të pacaktuar.
- 2- Për të eliminuar individët dhe grupet e vogla, të synuara të individëve me vrasje, larg shqyrtimit publik dhe gjyqësor.
- 3- Për të shfrytëzuar punën e detyruar të popullsisë së burgosur. Ky qëllim u rrit nga mungesa e fuqisë punëtore.

Administrimi i kampeve të përqendrimit ju besua qysh në krye SS-ve (Schutzstaffel), që do të thotë se kampet e përqendrimit ishin krejtësisht jashtë juridiksionit dhe mbikëqyrjes së gjykatave. Kështu pra, arsyeja pse absolutisht gjithçka, edhe gjërat më të paimagjinueshme mund të ndodhnin (dhe, në fakt, ndodhën) në kampet e përqendrimit, është sepse kampet e përqendrimit ishin një “hapësirë e jashtëzakonshme” ku gjendja e jashtëzakonshme – që në

⁴Marenglen Kasmi, fq

⁵ Hannah Arendt, *Origjinat e totalitarizmit*, Prishtinë, Dija, 2002, Fq. 441.

⁶Kampet e përqendrimit (Konzentrationslager; shkurtuar si KL ose KZ) ishin një tipar integral i regjimit në Gjermaninë naziste midis 1933 dhe 1945. Termi kamp përqendrimi i referohet një kampi në të cilin njerëzit mbahen të mbyllur, zakonisht në kushte të vështira dhe pa marrë parasysh normat ligjore të arrestimit dhe burgimit që janë të pranueshme në një demokraci kushtetuese.

thelb ishte një pezullim i përkohshëm i rendit ligjor mbi bazën e një gjendje faktike rreziku të jashtëm – u shndërrua në normë dhe kësisoj u bë e përhershme.⁷

Kampi i parë i përqendrimit i hapur në Gjermani ishte Kampi i Dahaut, në Bavari. Komandant i tij u emërua Theodor Eicke (17 tetor 1892 – 26 shkurt 1943)⁸, një funksionar i hershëm nazist SS. Organizimi, struktura dhe praktika e zhvilluar në Dachau në 1933–34 u bënë model për sistemin e kampit nazist të përqendrimit ndërsa ai u zgjerua. Ndër praktikantët e hershëm të Eicke në Dachau ishte Rudolf Höss, i cili më vonë komandoi kampin e përqendrimit në Aushvic. "Njësitë politike speciale në gatishmëri" (Politische Bereitschaften) fillimisht ruanin kampet e përqendrimit SS. Ata u riemëruan "Njësitë e Gardës SS" (SS-Äachverbände) në 1935 dhe "Njësitë e Kokat e Vdekjes SS" (SS-Totenkopfverbände) në Prill 1936. Një Njësi Kreu e Vdekjes SS u caktua në secilin kamp përqendrimi. Pas vitit 1936, administrata e kampit, përfshirë komandantin, ishte gjithashtu pjesë e Njësisë së Kreut të Vdekjes SS. Megjithëse të gjitha njësitë SS mbanin simbolin e kokës së vdekjes (kafkën dhe kockat e kryqëzuara) në kapelet e tyre, vetëm njësitë e kokës së vdekjes SS ishin të autorizuara të mbanin simbolin e kokës së vdekjes në jakat e tyre. "Divizioni i Kryesisë së Vdekjes SS" të SS Äaffen u krijua në vitin 1940. Oficerët e saj u rekrutuan nga shërbimi i kampit të përqendrimit. Ata gjithashtu mbanin simbolin e kokës së vdekjes në xhakatën e tyre. Njësitë e Kreut të Vdekjes SS në secilin kamp u nda në dy grupe. E para ishte stafi i kampit, i cili mbulonte:

- 1- komandanti dhe stafi i tij personal
- 2- një oficer i Policisë së Sigurisë dhe një asistent për të mbajtur dhe përditësuar të dhënat e të burgosurve
- 3- komandanti i të ashtuquajturit kamp mbrojtës mbrojtës (Schutzhaftragerführer) i cili strehonte të burgosurit dhe stafi i tij (përfshirë oficerin e shpërndarjes së punës, oficerin e thirrjeve me rrotull dhe Blockführer, të cilët ishin përgjegjës për kazernat individuale të të burgosurve)
- 4- një staf administrativ përgjegjës për administrimin fiskal dhe furnizimin e kampit

7

⁸Theodor Eicke (17 tetor 1892 - 26 shkurt 1943) ishte një funksionar gjerman SS gjatë epokës naziste. Ai ishte një nga figurat kryesore në zhvillimin e kampeve të përqendrimit nazist gjatë Holokaustit. Eicke shërbeu si komandant i dytë i kampit të përqendrimit Dachau nga qershori 1933 deri në korrik 1934 dhe së bashku me ndihmësin e tij Michael Lippert, ishte një nga ekzekutuesit e shefit të SA Ernst Röhm gjatë spastrimit në Natën e Thikave të Gjata . Në 1939, Eicke u bë komandant i Divizionit SS Totenkopf të Äaffen-SS, duke udhëhequr divizionin gjatë Luftës së Dytë Botërore në frontet perëndimore dhe lindore, dhe duke vazhduar zgjerimin dhe zhvillimin e sistemit të kampit të përqendrimit. Eicke u vra më 26 shkurt 1943, kur aeroplani i tij u rrëzua gjatë Betejës së Tretë të Kharkovit.

- 5- një infermieri e drejtuar nga një mjek SS i asistuar nga një ose dy oficerë sanitare SS dhe/ose porosi mjekësore.

Grupi i dytë përbënte shkëputjen e rojeve (SS-*Eachbataillon*), e cila para vitit 1939 ishte në forcën e batalionit. Modeli i krijuar nga Eicke në mesin e viteve 1930 karakterizoi sistemin e kampit të përqendrimit deri në rënien e regjimit nazist në pranverën e vitit 1945. Rutina e përditshme në Dachau, metodat e ndëshkimit dhe detyrat e stafit dhe rojeve të SS u bënë normë, me disa ndryshime, në të gjitha kampet e përqendrimit gjerman. Të tridhjetë kampet kryesore naziste të përqendrimit qenë të gjitha kampe të vdekjes, ku u zhdukën miliona qenie, viktima të urisë dhe të torturave. Raportet e shënuara nga autoritetet na bëjnë me dije se çdo kamp kishte Totenbuh-un, që nuk janë të plota dhe në shumë raste ato qenë prishur kur po afroreshin aleatët. Në Mathauzen është gjetur një pjesë e Totunbuh, ku janë regjistruar 35.318 vdekje, për periudhën nga mesi janarit 1939 deri në prill 1945.⁹ ARBEIT MACHT FREI (Puna do t'ju bëjë të lirë), ky është mbishkrimi ironik i vendosur në hyrje të kampeve të përqendrimit të cilat u kthyen në fabrika të vdekjes gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në fund të vitit 1942, kur qe nevoja për krahë pune Himleri udhëroi të zbritet përqindja e vdekjeve në kampet e vdekjes. Për shkak të mungesës së krahut të punës ai mbeti shumë i pakënaqur nga një raport që ia kishin dërguar shërbimet e tij, nga ku dilte se nga 136.700 persona të dërguar në kampet e përqendrimit në mes të qershorit dhe të nëntorit 1942, 70.610 njerëz kishin vdekur, 9267 ishin ekzekutuar dhe 27.846 ishin transferuar dmth qenë dërguar në dhomat e gazit.¹⁰

Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore dhe pushtimi gjerman në Shqipëri

Fuqizimi i Hitlerit dhe nazizmit në Gjermani solli në mënyrë të pashmangshme kërkesën për rivendikimet territoriale dhe hapësirën jetike të proganduar që në vigjilje të ardhjes në pushtet. Pas aneksimit të Austrisë më 22 mars 1938, Çekosllovakia ishte viktima e radhës së nazizmit dhe militarizmit gjerman. Duke marrë zemër nga rimilitarizimi i suksesshëm i landit të Rinit, më 1937, Hitleri filloi të kërcënonte Çekosllovakinë në emër të gjermanëve etnikë. Në fillim këto kërcënime ishin gjoja për t'u bërë presion çekëve t'i jepnin të drejta të veçanta minoritetit gjerman në "landin e Sudeteve", siç e quante këtë territor propaganda gjermane. Por më 1938 Hitleri e ngriti tonin e retorikës së tij, duke kërcënuar se

⁹ William L. Shirer. Ngritjadherwnia e RajhuttwTretw. Njwhistori e GjermaniswNaziste. VëllimiiII, Onufribotime, Tiranë, 2004, fq398

¹⁰William L. Shirer. Ngritjadherwnia e RajhuttwTretw. Njwhistori e GjermaniswNaziste. VëllimiiII, Onufribotime, Tiranë, 2004, fq 399

do t' i aneksonte me forcë Rajhut gjerman landin e Sudeteve. Për të shmangur fillimin e luftës u thirr Konferenca e Mynihut ku u diskutuan mënyrat sesi mund të shmangej kriza politike që kish ngërthyer Evropën. Konferenca e Mynihut u mbajt në 28 shtator dhe në 30 shtator 1938 , ku kryeministri i Britanisë së Madhe Çambërlen, Kryeministri i Francës, Dedalier, Kancelari gjerman Adolf Hitler dhe kryeministri italian Benito Musolini nënshkruan Paktin e Mynihut ku forcat çekoslllovakë duhet të tërhiqeshin nga krahina e Sudetëve dhe instalimet ushtarake çeke duhet t'u liheshin të paprekura forcave të armatosura gjermane. Në mars 1939, pak se gjastë muaj pas Munichut, Hitleri pushtoi atë që kishte mbetur nga Çekoslovakia. Pjesa çeke u bë protektorat gjerman, Sllovakia teknikisht u përcaktua shtet i pavarur, po të ishte satelit i Gjermanisë. Ndonëse Britania e Madhe dhe Franca kishin premtuar të bëheshin dorëzanës të Çekoslovakisë në Munich, ky premtim asnjëherë nuk u bë zyrtar dhe as që mund të bëhej. Shkatërrimi i Çekoslovakisë nuk kishte asnjë vlerë gjeopolitike; ai tregoi se Hitleri vepronte jashtë arsyes dhe shkondedrejti luftës. Pas mbrojtje dhe pa aleancat franceze dhe sovjetike, Çekoslovakia ishte e detyruarë binte gjermane dhe Evropa Lindore do t'i përshatej patjetër realitetit të ri të forcës.¹¹ Në 2 shtator 1939 Polonia u pushtua nga Gjermania Naziste dhe Bashkimi Sovjetik, duke humbur sovranitetin e vet. Stalini dhe Hitleri kishin një admirim reciprok për njëri-tjetrin, të dy këta njerëz në vitet 1939-1941 u gjendën në një rivalitet të pafalshëm. Po të studiojmë politikën e Vozhdit dhe Fyhrerit, do të konstatojmë se ata puqeshin në mjaft pika. Ata i bashkonte përbuzja ndaj demokracive perëndimore, së cilës i shtohet edhe urreja për hebrenjtë. Ndërsa njëri e përqendronte urrejtjen te personi i Trockit, tjetri përfshinte në urrejtjen e tij një popull të tërë.¹² Ishte ky pasion që vulosi marrëveshjen e tyre. Në prill, kur lufta naziste po bëhej e paevitueshme, domethënë pas copëtimit të Çekoslovakisë, Stalini hoqi nga detyra Ministrin e tij të Jashtëm, Litninov Finkelstajnin, një hebre i martuar me grua angleze, të cilin e zëvendësoi me Vajçesllav Molotovin. Këtë veprim Hitleri e konsideroi si gatishmëri për afrim. Kështu filluan edhe bisedimet sekrete, ku më pas Ministri i Jashtëm gjerman, Joachim von Ribbentrop nënshkroi Paktin e mos-sulmimit, të quajtur Pakti Molotov – Ribentrop, në prani të Stalinit më 23 gusht 1939 ne pallatin e Kremlinit. Ky pakt u pasua nga një traktat për tregtinë. Palët nënshkruan në mënyrë sekrete shtesa të Paktit në protokoll, që ishte të ndante Europën Qendrore sipas interesave, sferave të influencave për palët, gjë që bëri që Finlanda, vendet baltike, Besarabia dhe Polonia lindore të ishin në sferën e influencës sovjetike, ndërsa Polonia e mësipërme të ishte nën sferën gjermane. Një javë pas paktit trupat gjermane u futën në Poloni, që shënon ditën e parë të

¹¹ Henry Kissinger, *Diplomacia*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1999, fq 316.

¹² Leon Poliakov, *Totalitarizmi dhe Shekulli XX*, Përpjekja, Tiranë, 2010, faqe 97. 119

hapjes së frontit të Luftës së Dytë Botërore. Palët detyroheshin të ruanin neutralitet gjatë luftës me shtetet e palës së tretë. Tragjikisht, pakti i tyre i dha dorë të lirë Gjermanisë për të sulmuar Poloninë, më 1 shtator 1939. Në vitin 1939, menjëherë pas sulmit të Gjermanisë, në bazë të një sulmi të parapërgatitur, Polonia u pushtua nga rusët; në atë kohë Molotovi kishte thënë se miqësia midis Rusisë e Gjermanisë ishte çimentuar me gjak-gjakun polak.¹³ Pushtimi i Polonisë do të shënonte fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Ndërkohë Shqipëria e kishte humbur sovranitetin e vet pas agresionit fashist italian më 7 prill 1939. Shqipëria ishte një nga viktimat e para të të ashtuquajturit rend i ri fashist dhe konfigurimit të hartës gjeopolitike që Fuqitë e Boshtit dëshironin t'i jepnin botës. **Pas një qëndrimi prej katër vitesh nën pushtimin italian, Shqipëria u pushtua nga Gjermania Naziste në shtator 1943.**



Më 8 shtator 1943 u shpall kapitullimi i Italisë fashiste. Kapitullimi i Italisë fashiste erdhi si pasojë e disfatave që pësuan armatat gjermane e italiane në frontet kryesore të Luftës së Dytë Botërore. Pas disfatës të Gjermanisë në Stalingrad në 2 shkurt 1943, Italia humbi çdo

¹³UolltërLakër, Europa nëkohëntonë 1945-1992 ,Dituria, Tiranë, 2003, faqe 89

shpresë për të fituar luftën. Në 10 korrik forcat anglo-amerikane zbarkuan në Siçili dhe në gusht në Gadishullin e Apenineve, duke e rënduar më tej pozitën e Boshtit Fashist. Në rrethana të tilla, qeveria e Badolios, e cila kishte ardhur në fuqi, pas rënies së Musolinit, u detyrua të shpallte kapitullimin e Italisë dhe të fillonte bisedimet me aleatët për daljen nga lufta. Pas nënshkrimit të aktit të kapitullimit me Aleatët e Koalicionit Antifashist, mareshali Badolio njoftoi komandën e trupave italiane në Shqipëri se aleanca me Gjermaninë Naziste kishte marrë fund. Për rrjedhojë, do të ndërpritej çdo bashkëpunim me komandat dhe me repartet gjermane. Ndërkohë repartet italiane udhëzoheshin që të ndërprisnin veprimet luftarake kundra forcave partizane dhe forcave të tjera antifashiste, të hynin në lidhje me komandat e tyre dhe t'u thuhej se ishin të gatshëm të luftonin së bashku kundër trupave gjermane. Kur forcat anglo-amerikane zbarkuan në Sicili më 10 korrik 1943, e sidomos kur pas dy javësh Musolini u rrëzua nga fuqia, rëndësia strategjike e Shqipërisë doli në krye të shqetësimeve gjermane në rajonin e Ballkanit. Në funksion të përballimit të një zbarkimi të mundshëm anglo-amerikan në Ballkan, ku Shqipëria ishte vendi më i përshtatshëm, u bë edhe riorganizimi i forcave gjermane në rajon. Në korrik, pranë komandës së grup armatave italiane në Lindje me qendër në Tiranë u vendos një shtab gjerman i ndërlidhjes, ndërsa më 1 gusht filloi parashutimi i kompanive me ushtarë gjermanë për kontrollin e aeroporteve shqiptare¹⁴. Sapo u mor vesh lajmi i kapitullimit të Italisë, madje pa u bërë i panjohur publikisht, gjermanët nisën zbatimin e planit të pushtimit të Shqipërisë, që kishin hartuar më parë. Me kryerjen e veprimeve të parashikuara, në këtë kuadër u ngarkua Ministria e Jashtme e Gjermanisë dhe Vermahti. Lëvizja e parë politike që bëri Ministria e Jashtme gjermane, në prag të pushtimit, ishte emërimi i Herman Nojbaher¹⁵, kryetar i Bashkisë së Vjenës, në detyrën e të ngarkuarit të posaçëm të Gjermanisë në Europën Juglindore. Nojbaheri kishte punuar edhe më parë me Ballkanin, si përfaqësues i Hitlerit për çështjet ekonomike. Në këtë kohë do të vendosej edhe dërgimi në Shqipëri i majorit në pension, Fon Shajger, me rekomandimin e Shlipit, konsullit të përgjithshëm gjerman në Tiranë. Shajgeri ishte një njohës i mirë i realitetit shqiptar, pasi kishte punuar 20 vjet në Tiranë dhe kishte njohje të mira me disa personalitete, të cilat do t'i shërbenin për detyrën e ngarkuar. Shlipiti dha një përshkrim të përgjithshëm për gjendjen politike në Shqipëri, jo gjithnjë të saktë, por që hidhnin dritë mbi disa problem. Ata na urejnë neve më shumë për shkak se ne kishim lidhje

¹⁴-Paskal Milo, *Udhëkryqeshqiptaro-gjermane*, Toena, Tiranë, 2016, faqe 56-57

¹⁵Hermann Neubacher (24 qershor 1893 - 1 korrik 1960) ishte një politikan nazist austriak që mbante një numër postesh diplomatike në Rajhun e Tretë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ai u emërua si zyrtari kryesor i ministrisë së jashtme gjermane për Greqinë dhe Ballkanin (përfshirë Serbinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi).

me italianët, të cilët janë të urreyer për shqiptarët. *Çështja e ngritjes së një qeverie nën kontrollin gjerman doli se ishte problem i parë për Shqipëri. Qeveria e Libohovës ishte e kompromentuar për shkak të lidhjes së saj me italianët., ndërkohë që LNÇ përjashtojë krejtësisht nga kjo mundësi për shkak të lidhjeve të saj komuniste.*¹⁶Ai pohonte se ishte shumë e vështirë të gjeje njerëz me staturën e drejtuesit që të gëzoni popullaritet dhe autoritet e të mos kishin pasur lidhje me italianët. Shlipti e pa zgjidhjen më të mundshme për tu mbështetur tek shqiptarët e Kosovës, të cilët i cilësonte si njerëz të besës, ku arsyetonte se ata do ishin mirënjohës që gjermanët i kishin shpëtuar nga serbët.

Gjermania Naziste u vendos në Shqipëri në rrethana të vështira. Beteja e Stalingradit dhe ajo e Kurskut i kishin dhënë asaj goditje të pariparueshme. Fuqia dhe morali i trupave të Rajhut ishin në rënie të vazhdueshme. Veç kësaj zbankimi i ushtrive aleate në Italinë e Jugut dhe më pas kapitullimi i Italisë kishin goditur rëndë Boshtin dhe kishin dobësuar ndjeshëm fuqinë e tij luftarake në krahun jugor të Evropës. Duke pasur parasysh dështimin italian në Shqipëri, si dhe rrethanat e vështira që po kalonte Gjermania, u përpunuan edhe idetë për statusin që do të kishte Shqipëria e pushtuar. Në fillim Hitleri dha urdhër, që shqipëria të trajtohej si një “vend i pushtuar me dhunë”, por më pas ndryshoi mendim dhe urdhëroi që Shqipërisë t’i njihej statusi i një vendi me “pavarësi relative” dhe “sovrانيتet të kufizuar”, terma këto, të sajara për të mbuluar pushtimin ushtarak të vendit.¹⁷ Në Berlin mendohej se duhej të ngrihej një qeveri “shqiptare”, e cila do të kontrollohej nga autoritetet ushtarake të pushtimit dhe mendohej se në këtë mënyrë do të sigurohej më mirë qetësia, rendi dhe lëvizja e lirë. Ndryshe nga Italia, Gjermania do të përpiqej të krijonte përshtypjen, se nuk synonte dhe pretendonte as aneksimin dhe as kolonizimin e Shqipërisë, se ajo që e detyruar të ndërmernte aksion ushtarak këtu nga rrethanat e luftës. Autoritetet gjermane nuk ndërmorën veprime të rëndomta, si ndryshimin e flamurit e të simboleve të tjera kombëtare, ndërimin e emrave të shesheve e të rrugëve, siç kishin bërë fashistët italianë. Ata nuk u orvatën të bënin partinë naziste, siç bënin italianët me partinë fashiste dhe as vendos dhe as të vendosnin këshilltarë në çdo institucion, ose të organizoheshin organizma të posaçëm, që për çdo gjë të pyetej Berlini, siç që pyetur më parë Roma. *Ndërsa të gjithë të huajt bënin gabime në Shqipëri për shkak të mosnjohjes së vendit, gjermanët jo vetëm bënin më pak, por ata mësuuan shpejt nga gabimet e armiqve të*

¹⁶Bernd J. Fischer, *Shqipëria gjatë luftës 1939-1944*, Cabej, Tiranë, 1996, fq.215.

¹⁷Akademia e Shkencave, *historia e popullit Shqiptar*, toena, Tiranë, 2009, fq. 80-81.

tyre.¹⁸Shqipëria u trajtua edhe më ndryshe nga disa vende të tjera të pushtuara prej tyre, siç ishin: Franca, ku qeverisë së Vishisë i ishte lënë nën administrim vetëm një zonë e ngushtë, ose Norvegjia dhe Çekosllovakia, ku administrimi do të bëhej drejtpërdrejt nga autoritetet ushtarake, në Shqipëri u parashikua që qeverisja e vendit të bëhej nga vetë shqipëtarët. Pjesë e planit gjerman ishte edhe krahina e Kosovës, ku në kuadër të këtij plani ajo të ruante statusin dhe të drejtat që kishte patur nën pushtimin Italian, por të avanconin edhe më tej. Në premtimet gjermane përfshihej dhe krijimi i “Shqipërisë etnike”. Nazistët u përpoqën të përfitonin e të spekulonin sa më shumë me ndjenjat kombëtare e me dëshirat e ligjshme të kosovarëve, të dibranëve e të shqiptarëve të tjerë në Maqedoni e në Mal të Zi, që luftonin për të hequr qafe zgjedhën serbe. Gjermania mendonte se në këtë mënyrë, me pak kujdes e me shumë premtime, mendonte se do të arrinte të qetësonte shpejt gjendjen në vend dhe të fitonte simpatinë e mbështetjen e shqiptarëve. Ndërkohë rezistenca antifashiste e shqiptarëve e nisur që nën pushtimin italian u gjet para një sfide të re nga aksioni politik i gjermanëve që synoi të tërhiqte simpatinë e popullsisë shqiptare. Kapitullimi i Italisë krijoi një situatë të re, ku forcat e rezistencës shqiptare përcaktuan qëndrimin ndaj ushtrisë italiane, që ishte e shpartalluar dhe në pritje të urdhërit për largimin nga Shqipëria. Në direktivat e shtatorit 1943 udhëheqja e LANÇ i udhëzonte komandat e njësisve partizane për qëndrimin që duhej të mbanin në situatën e krijuar pas kapitullimit të Italisë. Qëndrimi që ata mbajtën ndaj ushtrisë italiane ishte “ në qoftë se kjo ushtri italiane nuk do të luftojë kundër nesh, ne do ta ftojmë në luftë me parullën, vllazërim në luftë kundër ushtrisë hitleriane dhe ushtarët italianë do t’i konsiderojmë si vllazër armësh; në rast të kundërt, në qoftë se do të vijojnë luftën kundër nesh, ne do t’i luftojmë ata njëllonj si gjermanët”.

Komanda gjermane e pushtimit bëri vendosjen e forcave në qendrat kryesore të vendit, gjatë bregdetit dhe gjatë vijave më të rëndësishme të komunikacionit. Në Shqipëri u dislokuan reparte të Korpusit XXI të Vermahtit, me qendër në Tiranë, dhe të Korpusit XXII që e vendosi komandën në jug të vendit. Veç këtyrë, gjatë bregdetit u vendosën reparte të artilerisë bregdetare, kurse në aerodrome, reparte të Luftvafes (Avijacioni gjerman). *Kryekomandat i forcave gjermane të pushtimit në fillim u caktua gjenerali Fen, kurse general i plotfuqishëm u caktua gjenerali Besel. i cili pas një muaji u zëvendësua nga gjenerali Gaib. Në krye të Gestapos gjermane u caktua gjenerali SS Fictum.*¹⁹Pushtuesi gjerman dislokoi në Shqipëri forca të shumta ushtarake, kur në tetor 1943 arriti në 57 mijë

¹⁸ Bernd J. Fischer, *Shqipëriagjatëluftës 1939-1944*, Cabej, Tiranë, 1996, fq.224.

¹⁹Akademia e Shkencave, *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll IV, Toena, Tiranë, 2009, fq. 78.

veta. Kurse në dimrin e vitit 1943 dhe në verën e vitit 1944 numri i tyre arriti në afro 70 mijë veta. Angazhimi i një force kaq të madhe në Shqipëri lidhej edhe me pozitën e saj strategjike dhe me interes strategjike të Gjermanisë në rajon. Për këtë arsye Nojbaheeri, i plotfuqishmi gjerman për Europën Juglindore shkruante se: “ *Shqipëria dilte në plan të parë, për shkak të pozicionit të saj në rrugën e ngushtë detare të Otrantos, në anën tjetër të së cilës ndodheshin forcat e armikut*”, pra forcat anglo-amerikane.²⁰

Në këtë kohë në Shqipëri, siç vlerësohej edhe në Berlin, kishte një lëvizje të fuqishme të rezistencës, e cila, së bashku me Ushtritë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë dhe Greqisë, ishin në gjendje të ndërmernin operacione në shkallë të gjerë, duke krijuar një gjendje të pasigurt për trupat e Vermahtit. Shqipëria shihej nga gjermanët edhe për pasurinë e saj minerale e me naftë, për të cilat industria gjermane e luftës kishte nevoja të ngutshme. Ata mendonin të nisin menjëherë shfrytëzimin intensiv të këtyre burimeve. Gjermanët nisën menjëherë shfrytëzimin e pasurisë të mbitokës dhe nëntokës shqiptare. Të gjitha këto pasuri u shpallën “ekonomi ushtarake” dhe për administrimin e tyre u krijua një department i posaçëm, i atashuar pranë konsullatës gjermane në Tiranë. Departamenti varej drejtpërdrejt nga i dërguari i posaçëm gjerman për Europën Juglindore, Nojbaheer.

Forcat e rezistencës shqiptare dita ditës po e risnin rolin e tyre dhe nuk e linin të qetë okupatorin. Prandaj detyra kryesore që Hitleri u ngarkoi trupave të pushtimit në Shqipëri ishte: “çarmatosja e shqiptarëve dhe e çetave shqiptare”. Ata për këtë shkak morën një sërë masash. Ata shpallën ligjin e luftës në vend dhe kërcënuan se se për “*çdo sabotim, të çdo lloji, do të pushkatoheshin pa gjyq 30 banorë, se për çdo ushtar gjerman të vrarë ose të plagosur do të viheshin në litar 10 shqiptarë*”.²¹Pavarësisht nga këto masa drastike të marra rezistenca antinaziste u rrit në një shkallë më të madhe. Ndërkohë që trupat naziste ndërmorrën akte të pashembullta dhune e terrori edhe mbi popullsinë civile si kundërpërgjigje ndaj forcave të rezistencës.

Trupat naziste që herën e parë që shkelën në territorin shqiptar përhapën panik duke pushkatuar njerëz të pafajshëm në fshatrat Borovë e Barmash të rrethit të Korçës. Forcat territoriale dhe batalioni antifashist “Tomori” kishin ditë që prisnin për të goditur forcat italiane që do shkonin në Përmet, pasi garnizoni italian ishte rrethuar nga forca të tjera të rezistencës. Në grykat e Barmashit ku kishin bërë pritë partizanët kaloi autokolona me një

²⁰Akademia e Shkencave, *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll IV, Toena, Tiranë, 2009, fq.7 9.

²¹Akademia e Shkencave, *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll IV, Toena, Tiranë, 2009, fq. 19.

përbërje prej 300 kamionash dhe autobлиндash, me ushtarë gjermanë, që bënë pjesë në Divizionin e I Malor. Sulmi i partizanëve shkatërroi 1 motorçikletë dhe u prishën disa makina, ku ngelën edhe disa ushtarë gjermanë të vrarë. *Lidhur me këtë ngjarje, komanda e xhandarmërisë njoftonte Ministrinë e Brendshme se “forcat gjermane tue ardhun nga Follorina, për kalim tranzit në Janinë, kur arritën midis katundeve Borovë-Barmash, u goditën nga çetat nacionalçlirimtare, të komanduara nga Riza Kodheli. Në këtë përpjekje, që vazhdoi për shtatë orë rresht, nga ushtria gjermane thuhet se mbetën të vrarë 4 ushtarë dhe të plagosur 12.*²²Nga kjo goditje e papritur trupat gjermane ushtruan terror të pashembullt mbi popullsinë e pafajshme dhe të pambrojtur të katundeve Borovë e Barmash, duke vrarë në Borovë 107 veta e plagosur 8 dhe po 8 veta në Barmash. Shumica e të masakruarve ishin gra me fëmijë të vegjël, vajza të pamartuara, por edhe fëmijë të vegjël. Masakra e Borovës është masakra e parë dhe më e madhe që nazistët gjermanë kryen ndaj popullsisë civile në Shqipëri në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Borova u bë simbol i sakrificës së popullit shqipëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në 5 shtator 1943, pra tre ditë para se të shpallej kapitullimi i Italisë, Herman Nojbaher thiri Xhafer Devën në Beograd, ku ky i sugjeroi emrin e Mehdi Frashërit si kandidatin kryesor për drejtimin e shtetit shqiptar, për arsyen se ai gëzonte simpati në sajë të fjalimit që kishte mbajtur kundër pushtimit Italian më 7 prill 1939. Ambasadori gjerman në Romë bindi Mehdi Frashërin, i cili ishte internuar nga qeveria italiane, të pranonte të vihej në kryesinë e shtetit shqiptar të “pavarur”. Më 12 shtator 1943, me miratimin e Nojbaher-it u formua një “komitet administrativ i përkohshëm”, i kryesuar nga Ibrahim Biçaku dhe anëtarë: Mehdi Frashëri, Lef Nosi, Bedri Pejani, Rexhep Mitrovica, Xhafer Deva dhe Rexhep Krasniqin.²³Komiteti u autorizua nga pala gjermane që të shpallte “Pavarësinë e Shqipërisë”, të formonte qeverinë e përkohshme dhe të shpallte Asamblenë Kushtetuese. Asambleja kushtetuese ose kuvendi kombëtar u hap më 16 tetor 1943. Më datë 18 tetor 1943 forcat partizane të Brigadës së III Sulmuese, qëlluan nga kodrat e Saukut pallatin, ku qene mbledhur asamblistët. Majori Shajger njohtoi menjëherë për këtë ngjarje Nojbaher-in dhe Ministrinë e Jashtme. Në njoftim thuhej: “*Sot në orën 10, derisa mbahej seanca e dytë, partizanët hapën zjarr dhe mortaja të rënda mbi ndërtesën e Kuvendit*”. Regjenca pati figurë kryesore Mehdi Frashërin dhe anëtarë Lef Nosin, Anton Harapin dhe Fuat Dibrën, personalitete, të cilat ishin të pakompromentuar me qeveritë kolaboracioniste të Italisë fashiste. Nojbaher deklaronte se

²²*Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Tiranë: 2008, fq. 80

²³Kristo Frashëri, *Histori e Qytetrimt Shqiptar*, Tiranë, 2008, fq. 313.

e linte në dorë të shqiptarëve formimin e qeverisë kombëtare dhe ngritjen e administratës shtetërore dhe se qëllimi i ushtrive gjermane ishte të kundërshtonin zbarkimin e forcave armike anglo-amerikane. Pas shumë diskutimesh më në fund u ra dakort që në postin e kryeministrit të emërohej Rexhep Mitrovica.

Ndërkohë rezistenca antifashiste kishte marrë hove më të mëdhaja çka solli dhe interesimin e drejtë për së drejtë të misioneve anglo-amerikane në terren. Serinë pranisë së tyre e nisi misioni i koduar "Consensus" (në fund të prillit 1943), i drejtuar nga majori Bill Maklin, Dejvis Smail e togeri Geri Defi, të cilët erdhën në Shqipëri nga Greqia dhe vazhduan punën e tyre në Shqipërinë e Jugut. Çdo mision i SOE në Shqipëri kishte emrin e vet të koduar dhe po ashtu çdo fluturim e çdo hedhje për një mision mbante emrin e koduar të misionit në fjalë dhe një numër në vazhdim. Ky mision pati rëndësi të veçantë, pasi me të u vendosën kontaktet e drejtpërdrejta me rezistencën shqiptare. Pas një qëndrimi të shkurtër u urdhërua të largohej nga Shqipëria, por u kthye përsëri bashkë me Dejvi Smailin dhe Xh. Emerin. Ardhja e tyre ishte në përputhje me strategjinë e Aleatëve. Britania e Madhe dhe aleatët në tërësi ishin të interesuar që të mbështesnin e të përkrahnin kudo forcat e rezistencës, pavarësisht nga orientimet e tyre ideologjike, në rast se ato angazhoheshin në luftime kundër agresorëve nazifashistë. Bazat e kushtet e krijuara prej tij pasuan në periudhën korrik-gusht 1943 hedhjen e 6 misioneve të tjera. Në datën 15-16 tetor erdhi në Shqipëri nga Biza misioni i kryesuar nga gjeneral brigade Edmund Dejvis, për të udhëhequr të gjitha misionet, ku dhe ishte misioni më i madh britanik në Shqipëri. Ai erdhi me një shtab të madh, me kolonelit A. Nikols, si shef shtabi. Misioni "Dejvis" do të bashkërendonte punën e grupeve angleze që vepronin në Shqipëri dhe do të ndihmonte në përmbushjen e misionit që atyre u ishte ngarkuar. Gjenerali Dejvis ishte dyzet e tre vjeç dhe e kishte kaluar gjithë karrierën e tij në ushtri. Oficeri kryesor i shtabit të tij ishte nënkoloneli Artor Nikols i Gardës Koltstrim, gjithashtu një ushtarak profesionist dhe fizikisht jo nga njerëzit më të fortë. Duhet thënë se kushtet në Shqipëri vinin në provë gjithë forcën fizike të burrave shumë më të rinj dhe shumë gjëra që ndodhën gjatë luftës në Shqipëri ishin një fyerje për parimet e larta dhe procedurat e shëndosha të oficerëve profesionistë eprorë.

Fund vjeshta dhe dimri i vitit 1943 rezultoi të ishte një nga periudhat më të vështira për rezistencën shqiptare. Ajo u gjend nën goditjen e drejtë për së drejtë të makinerisë së sofistikuar të pushtimit gjerman. Përgjatë muajit shtator 1943 u krijuan në Tiranë zyra e gjeneralit-SS Fitzthum dhe zyra e Komandës për Jashtë e Shërbimit të Sigurimit (Sicherheitsdienst –SD). Zyra e Fitzthum-it u emërtua "Përfaqësuesi i Drejtuesit SS të Rajhut

pranë Përfaqësuesit të Plotfuqishëm të Rajhut për Shqipërinë”. Kjo zyrë varej direkt nga Himmler-i dhe ishte po ashtu në varësi të Përfaqësuesit të Plotfuqishëm të Rajhut, ministrit Neubacher, që e kishte qendrën në Beograd. Kjo do të thotë që, gjithë urdhrat që kishin të bënin me çështje policore gjenerali Fitzthum i merrte nga Himmler-i ose Kaltenbrunner-i dhe udhëzimet politike i merrte nga Neubacher-i.²⁴Organizimi i brendshëm policor, gjurmimi i anëtarëve të rezitencës, arrestimi dhe dëpërtimi tyre drejt kampeve të përqendrimit i parapriu operacioneve ushtarake në shkallë të gjerë. Detyra e gjeneralmajorit SS Fitzthum ishte bashkëpunimi i ngushtë me qeverinë shqiptare dhe strukturat e policisë dhe xhandarmërisë, të cilat ishin një vegël në duart e nazistëve gjermanë. Po ashtu, një domosdoshmëri ishte edhe bashkëpunimi me legatën gjermane. Lidhja ndërmjet legatës gjermane në Tiranë dhe Fitzthum-it realizohej nga von Scheiger-i. Si rezultat i këtij bashkëpunimi merreshin vendimet se çfarë masash dhe politike duhej të ndiqej në Shqipëri.²⁵Për realizimin me sukses të gjithë masave dhe politikave që duhet të ndërmerreshin në vendet e pushtuara, sikurse edhe në Shqipëri, u ngritën komandat e Jashtme SD. Këto komanda ishin hallka ekzekutive e Gestapo-s dhe ishin të përhapura në çdo qytet dhe përbëheshin kryesisht nga gjashtë sektorë, që vareshin nga shtabi i komandës. Detyrat e kësaj komande SD për Shqipërinë ishin organizimi i kryengritjeve ndaj forcave partizane si edhe shkatërrimi dhe dobësimi i tyre si edhe marrja dhe vlerësimi i raportimeve të njerëzve të besuar (agjentëve) mbi aktivitetin politik të personave të rëndësishëm, mbi sabotimin ekonomik etj.²⁶ Sektori më i rëndësishëm i SD në Shqipëri që merrej me përndjekjen dhe arrestimin e njerëzve ishte edhe sektori i katërt, Sektori Gjyqësor. Ai merrej me gjithë dënimet e shqiptarëve që arrestoheshin. Po ashtu, ky sektor vendoste me gjyq ose pa gjyq për dërgimet në kampet e përqendrimit ose për burgosjet politike. Ky sektor përdorte në masë torturat çnjerëzore ndaj personave të arrestuar, me qëllim përfitimin e informacioneve prej tyre.²⁷ Qeveria e re dhe gjermanët duhej të luftonin me FNÇ gjithnjë e më të dominuar nga komunistët dhe më pas ishin në gjendje të detyronin pjesën më të madhe të rezistencës nacionaliste të bashkangjitej. Gjermanët filluan një seri ofensivash kundër partizanëve, të cilët ishin përqendruar kryesisht në Shqipërinë e Jugut dhe në një masë më të vogël në Shqipërinë Qendrore. Ofensiva e parë, operacioni "505", filloi në fillim të nëntorit 1943 për të pastruar njësitë partizane nga rajoni i Pezës dhe për të hequr kërcënimin për rrugën Durrës-Tiranë. Brenda tetë ditësh gjermanët e shpallën fushatën një sukses duke vrarë rreth 100 "banditë" dhe duke marrë mbi 1,650 të burgosur, të

²⁴MarenglenKasmi.

²⁵MarenglenKasmi.

²⁶MarenglenKasmi

²⁷MarenglenKasmi

gjithë ata, me marrëveshje të mëparshme, iu dorëzuan autoriteteve civile shqiptare. Balli Kombëtar u përfshi gjithashtu në luftimin e partizanëve gjatë ofensivës së Dimrit dhe në fund të dimrit FNÇ u gjend në vështirësi të konsiderueshme. FNÇ ishte afër rrezikut të shkatërrohej nga forcat gjermane dhe nacionaliste, me njësitë që arritën të shpëtonin nga rrethimi që vuanin nga mungesa e ushqimit, veshjeve dhe municioneve (pasi aleatët nuk ishin në gjendje t'i furnizonin ato nga ajri). Shifrat gjermane e çuan numrin e viktimave partizane në 2,239 deri në fund të janarit, 401 të vdekur në shkurt dhe 236 në mars. Deri atëherë të gjitha prefekturat e shtetit të ri, përveç Gjirokastrës në jug, mbetën në duart e qeverisë shqiptare.

Në pranverë të vitit 1944 komanda gjermane vendosi të ndërmernte një mësymje tjetër të përgjithshme, me forca më të mëdha se në mësymjen e dimrit. Qëllimi i saj ishte asgjësimi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Sipas planit në mësymje do të mernin pjesë forca nga katër divizione, gjithsej 40 mijë ushtarë. Kurse rreth 10 mijë forca kolaboracioniste vendase, do të kryenin kryesisht veprime ndihmëse. Kështu armiku kishte dy herë më shumë forca dhe një epërsi të pakrahësueshme në mjete e teknike luftarake. Pikërisht në këtë kohë, Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar vendosi të thërriste Kongresin e I Antifashist Nacionalclirimtar. Kongresi zhvilloi punimet në qytetin e lirë të Përmetit nga data 24-28 maj, me pjesëmarrjen e delegatëve nga i gjithë vendi. Kongresi mori një numër vendimesh me rendësi. Në përputhje me orientimet që dha Kongresi, Këshilli Antifashist mori vendimin për njësimin e Komandës së Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Këshilli vendosi gjithashtu dhënien e gradave në ushtri, si dhe krijimin e formacioneve të mëdha të ushtrisë Nacionalçlirimtare, të divizioneve e të korparmatave. Sapo përfundoi punimet Kongresi më 28 maj armiku filloj mësymjen e tij. Suksesi i fushatës së Dimrit dhe qershorit u tregua jetëshkurtër dhe partizanët u treguan shumë më elastikë sesa kishin parashikuar gjermanët, britanikët dhe shumë shqiptarë. Me krijimin e Aleancës së Madhe, gjermanët filluan të humbnin luftën. Me situatën aktuale që favorizonte komunistët, partizanët iniciuan një sulm në shkallë më të plotë kundër gjermanëve dhe Ballit Kombëtar.

Gjatë shtatorit dhe tetorit 1944 u çlirua një pjesë e mirë e qyteteve të shqipërisë si, Berati më 12 shtator, Gjirokastra më 18 shtator, 16 tetor Vlora, kurse Korça qyteti i fundit i okupuar në Shqipërinë e jugut u çlirua më 24 tetor 1944.

Luftime të përgjakshme pati akoma dhe tani ato ishin fokusuar në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranën, në të cilën për 19 ditë reshta pati luftime të mëdha. *Më 29 tetor 1944, me urdhër të*


*Shtabit të Përgjithshëm, filloi sulmi për çlirimin e plotë të Tiranës.*²⁸Më 30 tetor Shtabi i Divizionit të I partizan e vendosi selinë në qendrën e kryeqytetit. E përgjakshme ishte edhe Beteja e Mushqetas e 13 dhe 14 nëntorit 1944. Forcat armike ishin më shumë se 2 000 veta, me tanke, autoblanda që bënin pjesë në grupin “ Steyer”, ishin tërhequr nga Peqini dhe Elbasani dhe po drejtoheshin drejt Tiranës, ku synohej të godisnin mbas shpine forcat e UNÇSH që kishin rrethuar kryeqytetin. Në 15 nëntor 1944 repartet e forcave partizane u hodhën në sulmin vendimtar, në përfundim të së cilit pas 19 ditësh luftimesh, më 17 nëntor 1944 Tirana u çlithua. Gjatë 19 ditëve që vazhduan luftimet e Tiranës, garnizoni gjerman la më tepër se 2000 të vrarë, u zunë më shumë se 300 robër e të plagosur, u zunë 2 tanke, 1 autobлиндë, 25 topa, 200 automjete dhe gjithë materiali i kolonës armike. Në këto luftime partizanët patën 127 të vrarë e të plagosur, kurse nga popullsia civile me qindra vetë të masakruar barbarisht.

Çlirimi i Tiranës paralajmëroi çlirimin e gjithë Shqipërisë dhe ai ishte një ndër kryeqytetet e para në botë, i cili çlirohej me forcat e veta. Më 28 nëntor 1944 Qeveria Demokratike e Shqipërisë dhe kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar hynë në kryeqytetin e çliruar. Qyteti i fundit, i cili mbahej nga forcat hitleriane ishte Shkodra, ku për çlirimin e saj u ngarkuan Brigada e VI, VII, XXII, XXIII dhe Grupi partizan i Shkodrës. Luftime të ashpra u pënë përreth Shkodrës më 28 nëntor 1944, ku trupat gjermane u thyen. *Pas mesit të natës forcat armike e lëshuan qytetin. Në mëngjesin e datës 29 nëntor, në Shkodrën e lirë hynë luftëtarët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare.*²⁹

²⁸KristoFrashëri, *Histori e QytetritShqiptar*, Tiranë, 2008, fq. 326.

²⁹Akademia e Shkencave, *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll IV, Toena, Tiranë, 2009, fq. 102.

Arrestimet, deportimet në Mauthausen. Kampi i Mauthausen-it (1938-1945)



Disa nga format e ushtrimit të terrorit dhe dhunës naziste mbi popullsinë civile ishin pushkatimi i i civilëve për çdo ushtar gjerman të vrarë, arrestimet , dëbimet dhe internimet në kampet e përqendrimit si puna e detyruar larg vendit të origjinës. Më 22 tetor 1941 një gazetë franceze La Fur botoi shënimin e mëposhtëm: “Kriminelë burracakë në shërbim të Anglisë dhe të Moskës më 20 tetor në mëngjes vranë feldkomandantin e Nantës. Vrasësit ende nuk janë arrestuar. Për shlyerjen e krimit kam dhënë urdhër të pushkatohen 50 pengje si fillim 50 pengje të tjerë do të pushkatohen po qe se fajtorët nuk do të jenë arrestuar deri në mesnatën e 23 tetorit”. Në Francë në Belgjikë në Holandë në Norvegji në Poloni e në Rusi ky lloj njoftimi u bë i zakonshëm në faqet e gazetave, apo në afishet e kuqe me kornizë të zezë. Përpjestimi i shpallur publikisht nga gjermanët nuk ndryshonte kurrë: 1 – 100 pengje të pushkatoar për çdo gjerman të vrarë.³⁰

Ky terror që ushtrohej në vendet e pushtuara e kishte origjinën në strategjinë e terrorit të ushtruar në Gjermani që nga fillimet e ardhjes në pushtet të nazizmit. Nazistët goditën funksionarët e vegjël socialistë, ose antarët ndikues të partive kundërshtarë dhe u orvatën ti tregonin popullatës rreziqet e përfshirjes në antarësinë e thjeshtë. Për krimet që kryenin ata i pranonin, por as policia as gjykata nuk merrnin masa. Kjo tregonte se fuqia e nazistëve ishte më e madhe se ajo e autoriteteve dhe se ishte më e sigurt të ishte anëtar një organizate paraushtarake naziste sesa një republikan besnik.

³⁰William L.Shirer. Ngritjadhernia e RajhuttwTretw. Njwhistori e GjermaniswNaziste.VëllimiiII, Onufribotime, Tiranë, 2004, fq 386

Në Shqipëri, trupat naziste kryen masakrën e Borovës më 6 korrik 1943 ende pa e pushtuar administrativisht Shqipërinë. Trupat naziste që herën e parë që shkelën në territorin shqiptar përhapën panik duke pushkatuar njerëz të pafajshëm në fshatrat Borovë e Barmash të rrethit të Korçës. Forcat territoriale dhe batalioni antifashist “Tomori” kishin ditë që prisnin për të goditur forcat italiane që do shkonin në Përmet, pasi garnizoni italian ishte rrethuar nga forca të tjera të rezistencës. Në grykat e Barmashit ku kishin bërë pritë partizanët kaloi autokolona me një përbërje prej 300 kamionash dhe autobлиндash, me ushtarë gjermanë, që bënë pjesë në Divizionin e I Malor. Sulmi i partizanëve shkatërroi 1 motorçikletë dhe u prishën disa makina, ku ngelën edhe disa ushtarë gjermanë të vrarë. *Lidhur me këtë ngjarje, komanda e xhandarmërisë njoftonte Ministrinë e Brendshme se “forcat gjermane tue ardhun nga Follorina, për kalim tranzit në Janinë, kur arritën midis katundeve Borovë-Barmash, u goditën nga çetat nacionalçlirimtare, të komanduara nga Riza Kodheli. Në këtë përpyetje, që vazhdoi për shtatë orë rresht, nga ushtria gjermane thuhet se mbetën të vrarë 4 ushtarë dhe të plagosur 12.*³¹Nga kjo goditje e papritur trupat gjermane ushtruan terror të pashembullt mbi popullsinë e pafajshme dhe të pambrojtur të katundeve Borovë e Barmash, duke vrarë në Borovë 107 veta e plagosur 8 dhe po 8 veta në Barmash. Shumica e të masakruarve ishin gra me fëmijë të vegjël, vajza të pamartuara, por edhe fëmijë të vegjël. Masakra e Borovës është masakra e parë dhe më e madhe që nazistët gjermanë kryen ndaj popullsisë civile në Shqipëri në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Borova u bë simbol i sakrificës së popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Arrestimet dhe deportimet e njerëzve aktivë të rezistencës por edhe të civilëve të thjeshtë në kampet e përqëndrimit në Gjermani dhe Austri ishin mjeti tjetër i pushtetit administrativ ushtarak nazist në Shqipëri për të ushtruar terror. Në vjeshtën e vitit 1943, kryesisht në tetor dhe nëntor 1943 trupat gjermane në bashkëpunim me forcat kolaboracioniste realizuan dy operacione të ashtëquajtura spastrimi ndaj vatrave të rezistencës në Vlorë dhe Durrës. Aksionet e ndërmarra në formën e shpejtë të mënyrës naziste synonin sa të shuanin vatrat e rezistencës po aq dhe të siguronin bregdetin shqiptar nga çdo zbarkim i mundshëm i trupave aleate që ndosheshin në Itali.

Vlora

Më datën 10 tetor 1943 në orën 4:30 të mëngjesit forcat gjermane të qytetit të Vlorës ndërmorrën operacionin ku u arrestuan shumë qytetarë vlonjatë. Ata nuk do të ndaleshin vetëm në datën 10 tetor. Më 25 tetor ndërmorrën një operacion tjetër ndërshkimor i cili do të

³¹*Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Tiranë: 2008, fq. 80

vazhdonte deri në datën 6 nëntor. Të arrestuarit i hipën në kamione dhe i nisën drejt Kampeve të Përqëndrimit. Dokumentet në Arkivën e Shtetit dëshmonjnë mbi operacionin ndërshkimor gjerman si dhe arsyet përse u ndërmorr pikërisht në Vlorë. Mes tyre shquan raportimi që ka bërë komandanti lokal gjerman për Vlorën Jaquet, komandant i batalionit të I të regjimentit 54 të gjuajtësve alpinë. Ai i drejtohet shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Korparmatës së 21 Malore, Kolonelit Kaulbach. Dokumenti ka titullin “Organizimi dhe zbatimi i operacionit të spastrimit kundër bandave komuniste në qytetin e Vlorës.”

"Prej datës 13 shtator deri më 11 tetor 1943, isha komandant lokal i qytetit të Vlorës. Nga autoritetet lokale mora vesh se Partia Komuniste përfshinte rreth 60-70% të krejt popullsisë së këtij qyteti. Partia Komuniste, me anë të shpërndarjes gjerësisht të trakteve dhe ngjitjes së afisheve nëpër mure, u bëri thirrje tregtarëve për bojkotim etj, duke ndezur kështu një luftë të brendshme në këtë qytet, e cila do të kurorëzohej me një kryengritje kundër gjermanëve nga mesi i tetorit. Plaçkitjet dhe vjedhjet në depot e armëve, të municionit dhe veshmbathjes së ushtrisë italiane dhe në stacionet e spitaleve ushtarake kryheshin në mënyrë të planifikuar dhe në shkallë të gjerë. Duke ditur se çdo ditë po tërhiqeshin trupa gjermane nga kjo zonë, mendonin se deri nga mesi i tetorit do të arrihej një dobësim i trupave gjermane në Vlorë dhe rreth saj. Sjellja korrekte e gjermanëve në Vlorë u muar si dobësi.

Mbasi raportova përpara divizionit 100 të gjuajtësve alpinë, gjeneralit Utz, u ngarkova me zbatimin e një aksioni spastrimi në Vlorë, për të arrestuar udhëheqësit e Partisë Komuniste dhe për t'i dalë përpara sulmit të planifikuar kundër Vermahtit gjerman.

Organizimi dhe zbatimi i bastisjeve:

- a) Një kompani e gjuajtësve alpinë u caktua për bllokimin e krejt qytetit në të gjithë rrugët, udhët dhe grykat që dalin nga Vlora.
- b) Një togë me çiklistë të regjimentit dhe 4 tanke u caktuan për shërbimin e patrullimit gjatë aksionit në gjithë qytetin, për të penguar dalien e civilëve në rrugë.
- c) Për bastisjen e mirëfilltë u caktuan grupe (nga një grup për çdo lagje).

Përbërja e gupeve: Nga 20-25 ushtarë. 1 anëtar i feldxhandarmërisë, 1 xhandar civil, 1 kujdestar civil nga çdo lagje.

Armatimi dhe pajisja e grupeve: Revolver, automatik, 1 mitraloz dhe bomba dore, si dhe revolver pëx raketë ndriçuese, llampa dore dhe shufrra. Çdo grup kishte mundësi lëvizjeje, që

garantohej nga dy kamiona për secilin grup. Udhëheqësi i grupit, me veturë. Për qëllime lajmërimi ishin caktuar motoçikleta dhe biçikleta. Ndarja e kohës:

Tetë nëpunës të xhandarmërisë shqiptare u dërguan në selinë e komandaturës, nën pretekstin e një patrullimi të përbashkët gjatë natës. Detyra e këtvre anëtarëve xhandarmërisë shqiptare ishte t'i tregonin grupit gjerman shtëpinë e të ashtuquajturit kryeplak (kujdestarit të lagjes). Në ditën e operacionit të bastisjes, qyteti ishte bllokuar nga brenda dhe jashtë, duke filluar nga ora 4 e mëngjezit. Në orën 4 u zhvillua bisedimi i fundit në komandaturën lokale. Çdo grup kishte një listë të udhëheqësve të Partisë Komuniste, që duheshin arrestuar. Në orën 4.30, grupet gjermane u nisën menjëherë në të njëjtën kohë në lagjet e veçanta të caktuara dhe filluan me arrestimet e udhëheqësve komunistë sipas listës. Pjesa më e madhe e tyre u nxuar nga krevatet.

Një pjesë e komunistëve që u arrestuan, të cilët ishin futur në krevat me revolver të ngarkuar, me pushkë të ngarkuar dhe me bomba dore, bëri rezistencë, por kjo rezistencë e tyre u thye me shpejtësi dhe në mënyrë energjike. Shtëpitë e personave që do të arrestoheshin, në mënyrë të planifikuar u rrethuan, kështu që ishte e pamundur të iknin. Udhëheqësit e grupeve hynë në shtëpitë bashkë me 3-4 ushtarë nga më të fortit, arrestuan komunistin dhe bënë një kontroll të hollësishëm të shtëpisë nga bodrumi deri në çati, për të kërkuar municion, armë dhe plaçkë tjetër të zënë italianëve. Në këtë mënyrë u zu një depo e madhe armësh dhe municioni me armë dore të rënda e të lehta, rreth 3 tonë municion dhe sasi të mëdha veshmbathje dhe pajisesh italiane si dhe materiale mjekësore. Aksioni përfundoi rreth orës 8.00. U arrestuan gjithsej **393** vetë. Mbas një kontrolli të hollësishëm të të gjithë të arrestuarve me ndihmën e përkthyesve, në bazë të të dhënave të autoriteteve u mbajtën 160 komunistë, tek të cilët u gjendën armë dhe municion. Komunistët që u mbajtën, u futën në burgun civil të qytetit dhe të nesërmen u dërguan në Semlin, afër Beogradit. Duket se shefi komunist i zonës Rrahman Dibra, e ka lënë qytetin. Gjatë një kontrolli të të sëmureve në spitalin civil u zbuluan 6 partizanë të plagosur. Në zyrën e spitalit civil të fshehura mbrapa akteve, u gjendën revolverë, municion gjerman dhe italian si dhe bomba dore. Me këtë ndërhyrje të befasishme u arrit në fakt, që të zbulohen dhe arrestohen të gjithë udhëheqësit kryesorë të pranishëm në qytet. Në këtë mënyrë u krye plotësisht detyra dhe u ndalua kryengritja e planifikuar e Partisë Komuniste. Në një letër të Partisë Komuniste dërguar një njeriu të besueshëm, Partia

Komuniste pranonte vetë se gjatë kësaj bastisjeje kishte humbur shumë nga udhëheqësit e partisë, të cilët tani ishin në burg dhe duheshin liruar me doemos³²

Nga të 393 të arrestuarit vetëm 160 u mbajtën dhe u dërguan në Kampin e Përqendrimit Semlin³³afër Beogradit.Më andej një pjesë e tyre u dërguan në Kampin e Mauthausen-it në Austri.

Durrësi

Një operacion tjetër ndërkimor u zhvillua dhe në qytetin e Durrësit ku sërish u arrestuan anëtarë të rezistencës antifshiste dhe qytetarë durrsakë. Nga dokumenti datë 17.11.1943 informohemi për nisjen e repartit tankist-gjuajtës dhe të batalionit të 3-të 522 drejt Durrësit, Shijakut dhe Kavajës, në datat 19 dhe 20 nëntor. Me këtë rast njoftohet se që nga data 17.11 e gjer më 21.11.1943 "Tirana do të mbetet përkohësisht pa trupa, pasi ata do të sigurojnë rrugën Tiranë-Durrës në pjesën veriore të saj". Këtu bëhet fjalë për bastisjet masive që do të bënin gjermanët nën emrin konvencional "Hefenfahrt" (Shëtitje në port). Regjimenti "Grenadier-522" mbylli dhe bllokoi nga brenda e nga jashtë gjithë rrugët e Durrësit e të Shijakut. Në një dokument tjetër të armikut thuhet: "U kapën hëpërhë të gjithë burrat që u gjendën, dhe të tjerë, të cilët u futën brenda nga jashtë, me automjete, nga të dy krahët, nga Tirana dhe Rrogozhina..." Nga dokumenti i datës 21.11.1943, domethënë, katër ditë më vonë, mësohet se: "... Gjatë bastisjeve në Durrës, Shijak e Kavajë më 20 dhe 21 nëntor, u kontrolluan gjithsej 6700 burra, nga të cilët u arrestuan 812 komunistë të Shqipërisë..."Një dëshmitar i mbijetuar i këtyre arrestimeve dhe deportimev e drejt Kampit të Mauthausen-it , Abdulla Krutani rrëfen se "Unë jam internuar në vitin 1943 dhe deri nga fundi i nëntorit kam qenë në burgun e Tiranës, me shokët Kozma Nushi, Talat Noka. Më pas na çuan në tokat e Jugosllavisë, në kampin e Zemunit, pastaj në Beograd ku kemi ndenjur nga 5 muaj në secilin vend. Pastaj na çuan në perëndim. Kur më kapën, isha partizan, në Pezë. Aty na kapën mua

³²AQSH, Bobina T 314-661 me mikrofilm 000947. Dokumentet gjermane të kohës së luftës.

³³Kampi i përqendrimit Sajmište (shqiptohet [sājmi:jtɛ]) ishte një kamp përqendrimi dhe shfarosjeje naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ajo u vendos në vendin e panairit të Beogradit pranë qytetit të Zemun, në Shtetin e Pavarur të Kroacisë (NDH). Kampi u organizua dhe u operua nga njësitë SS Einsatzgruppen të vendosura në Serbinë e okupuar. U bëoperacionalnështator 1941 dhe u hap zyrtarisht më 28 tetortëatijviti. Gjermanët e quajtënatëkampinhebreñZemun (gjermanisht: JudenlagerSemlin). Në fund tëvitit 1941 dhenëfillimtvitit 1942, mijëragra, fëmijëdhepleqhebreñj u sollënnëkamp, sëbashku me 500 burra hebreñjdhe 292 gradhefëmijëromë, shumica e tëcilëveishinngaNiš, SmederevodheSabac. Gratëdhefëmijët u vendosënnëkazeremat e improvizuaradhevuajtëngjatëepidemivetëshumtatëgripit.

Tëmbajturnëkushtetëkëqija, atyreiusiguruansatitëpapërshatatshmeushqimidheshumëprejtyrengrinëpërvdekjegjatëdimrittë 1941-42. Midis marsitdhemajit 1942, gjermanët përdorënnjëfurgongazitëdërguanngaBerlinipërtëvramëmijëratëburgosurhebre. Gjatëkësajkoheaty u internuanmbajtipartizanëtjugosllavëtëkapur rob, çetnikë, simpatizantët e lëvizjevetërezistencësgrekedheshqiptare.

<http://ëëë.open.ac.uk/socialsciences/semlin/en/>.

dhe shumë shokë të tjerë. Udhëtimi ka qenë me autokolonë deri në Beograd, pastaj me tren drejt perëndimit. Rruga deri në kamp ka qenë një sfidë më vete, ku gjermanët nga frika e ndonjë revolte për arratisje i linin të burgosurit të thaheshin për ujë. Nuk na jepnin ujë fare. Mbaj mend që binte shi dhe qitnim duart jashtë për të njomur pak buzët. Na kishin rrethuar me tela që mos të kishim mundësi të arratiseshim. Aty na vdiq një shok, gjatë udhëtimit. Pandi Dhimo, korçar, alamet djali. Vdiq për një pikë ujë”, më thotë me zërin e qartë.³⁴Prej andej në shtator të vitit 1944 të arrestuarit shqiptarë u dërguan në Kampin e Mauthausen-it.

Një dëshmitar tjetër Enver Plepi kujton momentin e arrestimit në Durrës. "Hafenfahrt", (shëtitje në port) e quajtën gjermanët operacionin në të cilin u mobilizuan afër 4 mijë ushtarë. "Unë po kthehesha nga Kavaja, ku kisha shkuar te njerëzit e mi, kur hasa në një postbllok, nuk mendova se do të kishin ndonjë gjë me mua dhe kështu qëndrova. Më vunë në radhë me shumë të tjerë. Ende nuk e dija se çfarë fati po më përgatitej". Kishte nisur kalvari i gjatë i qindra njerëzve. Shumë nuk u kthyen më kurrë."Na grumbulluan te një shesh i madh atje, ku më pas u ndërtua Uzina e Plastikës. Pas nja dy orësh na nisën për Tiranë me disa kamionë të mëdhenj ushtarakë. Duhej të kemi qenë aty rreth 600 vetë nga Durrësi. Shumica ishin në moshë, vetëm unë e nja tre katër të tjerë ishim të rinj. Në Tiranë na kanë strehuar në Burgun e Ri, atje ku është sot Reparti 313. Për afër dy ditë ka vazhduar seleksionimi. Mbaj mend një shqiptar që ndihmonte gjermanët në këtë punë. Mbante një pardesy dhe një borsalinë të madhe, quhej Osman Velja. Ai i njihte vetë personalisht shumicën prej nesh. Atëherë kam dëgjuar për herë të parë në jetën time komandat: Rechts, links (majtas, djathtas). Nga seleksionimi i parë mbetëm 200 vetë dhe më pas kemi qenë aty afër 100 që mbetëm në fund. Na patën thënë se gjatë këtyre ditëve shumë njerëz ishin mbledhur para dyerve të burgut në pritje të fatit tonë. Madje, andej nga paraditja e 28 nëntorit, Ditës së Pavarësisë, ky grumbullim ishte shndërruar në një demonstratë të heshtur. Që atëherë, në ndonjë rast që më bie të kaloj andej nga burgu, i hedh sytë asaj dritares me hekura të burgut. Më duket sikur e përjetoj edhe një herë po aq fort, frikën dhe ndjenjën e pasigurisë që na kishte kapur në atë kohë. Pastaj na hipën në kamionë. Me këtë rast mësova edhe një fjalë tjetër gjermanisht: Komm (eja). Me dy ushtarë gjermanë para dhe katër mbrapa, kamionët morë rrugën e Elbasanit. Kemi ndenjur një ditë në burgun e këtij qyteti për të mbërritur më pas në Strugë. Mbaj mend se na kishin mbetur ende disa para nëpër xhepa dhe na dhanë leje të blejmë ca petulla, të cilat i përpimë brenda pak minutash. Në Strugë jam njohur edhe më mirë më

³⁴Jonida Hitoveizi. Rrëfimi i Abdullah Krutanit, shqiptari që jetoj tmerrin në kampin nazist. Gazeta Kronika.21/10/2019.<https://gazeta-kronika.com/2019/10/rrrefimi-i-abdullah-krutanit-shqiptari-qe-jetoi-tmerrin-ne-kampin-nazist/>

Kozma Nushin, Telat Nogën, Enver Veljen, Vasil Misjen, Leonidha Hebën dhe të tjerë. Në darkë kemi mbërritur në Manastir, ku na kanë mbajtur afër një muaj. Na kanë marrë gjatë në pyetje dhe më në fund na lajmëruan se destinacioni ynë i fundit ishte internimi. Se ku do të na çonin, as që e shkonim atëherë ndërmend."Deri në atë kohë kishim dëgjuar për egërsinë e trajtimit në burgjet naziste, por të dëgjosh është tjetër gjë dhe ta provosh e ta shohësh vetë me sy është tjetër gjë - vazhdon Enveri rrëfimin tashmë krejt i përfshirë nga kujtimet e asaj kohe - në korrik të 1944 na kanë sjellë me tren në Zemun, një kamp i madh përqendrimi në Serbi. Atje kishte afër 5 mijë të internuar nga i gjithë Ballkani, që më pas i nisnin për në kampe të tjera. Mijëra vetë flinin në një ndërtesë trekatëshe të ngjitur me njëri-tjetrin. Këtu nisëm të nuhasim për herë të parë erën e vdekjes. Ishte shumë keq për ushqim dhe ujë. Nuk vonoi shumë dhe ra një epidemi e rëndë tifoje. Qindra të burgosur vdiqën. Këtu humbëm të parët shokë nga Durrësi. 18 durrsakë nuk e përballuan dot sëmundjen. Në Zemun më kanë bërë përshtypje dy njerëz, që nuk do t'i harroj sa të jetë jeta. Njëri prej tyre ishte Mihal Konomi, nga Vlora. Ai ishte mjek dhe gjermanët i propozuan kushte më të mira nëse pranonte të ishte mjeku zyrtar i kampit. Vasili nuk pranoi, qëndroi pranë nesh duke na ndihmuar sa kishte mundësi, por nuk u nda nga shokët. Një tjetër emër më ka mbetur në mendje: Mihal Marko. Ky më dha një batanije. Tani mund të duket një gjë e vogël, porse në atë kohë ishte gati si të të shpëtonte jetën. Për fat, të dy i mbijetuan kampeve dhe u kthyen pranë familjeve. Nuk kaloi shumë kohë dhe na bënë sërish gati për nisje me trena. Këtë herë destinacioni ishte Banica, një rrethinë e Beogradit. Këtu, një godinë katërkatëshe e gjimnazit ishte shndërruar në burg politik. Ne, shqiptarëve, na strehuan në disa baraka të lehta në oborrin e burgut. E kuptuam se këtu nuk do të rrinim shumë. Tortura më e madhe në Banac ishte uria. Ishte një vuajtje e pashoqe që ia paska kaluar çdo lloj torture, porse pas disa ditësh u gjet një zgjidhje. Me anë të alfabetit me gishta, si ai që përdorin shurdh-memecët, arritëm të lidheshim me të burgosurit që ndodheshin në qelitë përballë nesh. Ata ishin diçka më mirë se ne, sepse një herë në javë u vinte ushqim nga familja. Ata nisën të vinin ushqime në parvazin e dritareve të tyre. Mirëpo që të shkoje deri te dritaret e tyre me hekura ishte fort me rrezik, sepse rojet qëllonin pa paralajmërimin çdo njeri që kapërcente oborrin e barakave. Mbjaj mend që këtë punë e kemi bërë unë, Mustafa Elezi, nga Kavaja, dhe ndonjë shok tjetër.³⁵ Më andej Enver Plepi dëshmon për dërgimin e tij dhe të shqiptarëve të tjerë drejt Kampit të Mauthausen-it. "Ishte 15 shtatori i 1944. Na hipën nëpër disa vagonë mallrash të gjithë ngjitur njëri me tjetrin. Pa bukë, pa ujë dhe pa dalë. Merrnim ajër vetëm nga disa dritare të

³⁵FatosBaxhaku. Aferdhelarg. Rrëfimet e durrsakut, qëmbijetoinë Mauthausen. G. Shqip, 08/04/2007.

vogla lart. Prej tyre mësonim nëse ishte natë a nëse ishte ditë. Udhëtimi ka zgjatur pesë ditë. As që e kishim idenë se ku po shkonim e çfarë vendesh po kalonim. Hera e parë që zbritëm në tokë në mes të udhëtimit ishte kur dha shpirt Vasil Gjata, ish-polici i Bashkisë së Durrësit. E vendosëm trupin e tij në anë të hekurudhës dhe nuk morëm vesh më tej se ç' u bë me të. Në një farë kuptimi, Vasili i shkretë u bë viktima e parë e Mauthausenit të mallkuar. Në 20 shtator 1944 e dëgjova për herë të parë emrin e tij: Mauthausen - vazhdon dëshminë e tij Enveri - ishim në Austri, në afërsi të Linzit. Na rreshtuan para portës së tij të madhe dhe pashë pas saj me mijëra figura njerëzore që lëviznin si pa kuptim. Mijëra vetë të veshur me rrobe me vija vërtiteshin në një peizazh krejt të zhveshur. Ndërsa po prisnim, m'u afrua si me ndrojtje një figurë e mjerë. M'u drejtua në italisht. I thashë se vijmë nga "Durazzo". Tundi kokën me trishtim dhe bëri me gisht nga porta e kampit: E sheh atë portë, ajo është porta e hyrjes. Deri tani nuk ka pasur portë daljeje. Por ti je i ri, do Zoti dhe mbijeton. Kurrë nuk do të më hiqet nga mendja portreti i atij njeriu. Më pas na zhveshën lakuriq dhe na i morën të gjitha rrobat. Para se të vishnim uniformat bardhë e blu, na çuan në dushe. Vonë, shumë më vonë, e kemi marrë vesh se kishte dy lloj dushesh: njëri ishte ky që bëme ne. Tjetri të çonte direkt drejt vdekjes, ishin dhomat me gaz. Ne shpëtuam, ishim të rinj. Një ditë më pas nisi ferri i vërtetë. Na çuan në punë që në të gdhirë. Që tani e tutje nuk ekzistonin më emra. Ne ishim vetëm numra. Unë e kisha 100266. E gjithë puna ishte që të mbaje një gur afër 20-30 kile në kurriz nga gurorja deri në afërsi të kampit, ditë për ditë, në dimër e në vapë, në të ftohtë a në shi, e njëjta gjë që të çonte drejt vdekjes së sigurt. Të rreshtuar për katër, nën komandën e atyre që i quanin "kapo", që ishin të burgosur të privilegjuar, duhej të kapërcenim me dhjetëra herë në ditë të 183 shkallët e së përpjetës së mallkuar të gurores. Mbaj mend Telat Nogën, që u mundua të ndihmonte një të burgosur që u shemb përdhe. Kapot vrapuan sakaq drejt tij. Ishte e ndaluar të ndihmoje tjetrin. Kush ishte i dobët duhej të vdiste. Ky ishte rregulli. Me të vdekurit nisën të na mësohen sytë. Ata i shihje kudo: në gurore, në rrugët e kampit, në banjo, kudo. Mbaj mend që një mëngjes, kur u zgjova, pashë se shoku im i krevatit kishte dhënë shpirt. Nuk e mësova kurrë se nga ishte. Ishim aq të lodhur e të paushqyer sa që nuk kishim as fuqi për të folur. Kështu vazhdoi jeta jonë, nëse mund të quhet jetë deri në majin e 1945. Nga Shqipëria kishim ardhur mbi 400 vetë, tani kishim mbetur një grusht. Të tjerët, Kozmai, Telati, Enver Velja, e shumë e shumë të tjerë nuk e përballuan dot. Po sikur edhe pak ditë të kishte vazhduar kjo histori, tani nuk do të ishim duke folur këtu bashkë".³⁶

³⁶Fatos Baxhaku. Afer dhe larg. Rrëfimet e durrsakut, që mbijetoi në Mauthausen. G. Shqip, 08/04/2007.

Kampi i Mauthausen-it

Të arrestuarit shqiptarë anëtarë të rezistencës si dhe viktimat mes popullsisë civile të arrestuar nga represaljet e ushtrisë naziste në Vlorë dhe Durrës ndoqën itinerare të ndryshme përmes ish Jugosllavisë por destinacioni përfundimtar për një pjesë të madhe të tyre ishte Kampi i Mauthausen-it në Austri. Mauthausen ishte një kamp përqendrimi nazist në një kodër mbi qytetin e tregut të Mauthausen (afërsisht 20 kilometra (12 mi) në lindje të Linz-it), Austria e Epërme. Ishte kampi kryesor i një grupi me afro 100 nënkampet e tjera të vendosura në të gjithë Austrinë dhe Gjermaninë jugore.³⁷ Tre kampet e përqendrimit Gusen në dhe përreth fshatit St Georgen/Gusen, vetëm pak kilometra nga Mauthausen, mbanin një pjesë të konsiderueshme të të burgosurve brenda kompleksit të kampit, duke tejkaluar ndonjëherë numrin e të burgosurve në kampin kryesor të Mauthausen. Kampi kryesor Mauthausen funksionoi nga koha e Anschluss, kur Austria u bashkua me Gjermaninë naziste më 8 gusht 1938, deri më 5 maj 1945, në fund të teatrit evropian të Luftës së Dytë Botërore. Duke filluar me kampin në Mauthausen, numri i nënkampeve u zgjerua me kalimin e kohës dhe deri në verën e vitit 1940 Mauthausen dhe nënkampet e tij ishin bërë një nga komplekset më të mëdha të kampeve të punës në pjesën e kontrolluar nga Gjermania të Evropës. Ashtu si në kampet e tjera të përqendrimit nazist, të burgosurit në Mauthausen dhe nënkampet e tij u detyruan të punonin si skllëvër, në kushtet që shkaktuan shumë vdekje. Mauthausen dhe nënkampet e tij përfshinin gurorë, fabrika municionesh, miniera, fabrika armësh dhe uzina që grumbullonin avionë luftarakë.³⁸ Në janar 1945, kampet përmbanin afërsisht 85,000 të burgosur.³⁹ Numri i të vdekurve mbetet i panjohur, megjithëse shumica e burimeve e vendosin atë midis 122,766 dhe 320,000 për të gjithë kompleksin. Një nga kampet e përqendrimit nazist nga më jetëgjatët në Rajhun e Hitlerit, Mauthausen mori dërgesën e parë të vagonëve me njerëz në vitin 1938. Deri në kohën kur edhe 50 satelitë të tjerë si ai, u çliruan nga trupat amerikane në maj të vitit 1945, më shumë se 100.000 njerëz gjetën vdekjen aty, shumica në kampin kryesor. Ai gjendet në Austrinë e Epërme pranë qytetit Linz dhe ishte një vend ku punohej për të thyer gurët. U përcaktua si një kamp që i takonte kategorisë së tretë dhe ishte lloji i vetëm i kësaj kategorie në hapësirat e Rajhut ku njerëzit vdisnin nga puna e

³⁷Stanisław Dobosiewicz (2000). Mauthausen–Gusen; obrońcy życia i ludzkiej godności [Mauthausen–Gusen; in defence of life and human dignity]. Ęarsaĕ: Bellona. pp. 191–202; Gnter Bischof; Anton Pelinka (1996). Austrian Historical Memory and National Identity. Transaction Publishers. pp. 185–190.

³⁸Haunschmied, Mills, Ęitzany-Durda (2008), pp. 172–175; Geoffrey R. Ęalden (2 July 2000). "Gusen Concentration Camp / Project B-8 "Bergkristall" Tunnel System". The Third Reich in Ruins. Retrieved 15 April 2015

³⁹Stanisław Dobosiewicz (1977). Mauthausen/Gusen; obzragłady [Mauthausen/Gusen; the Camp of Doom]. Ęarsaĕ: Ministry of National Defence Press. p. 449.

rëndë. Gratë e sjella aty përbënin 2,5 për qind të numrit në total të të burgosurve. Më së shumti u detyruan të prostituonin, ndërsa ato shtatzëna u përdorën në eksperimente shkencore. Kishte fëmijë e të rinj, jeta e të cilëve nuk zgjati shumë. Mesatarja e tyre shkonte nga 6 deri në 15 muaj. Qindra e mijëra në kompleksin e Mathausenit, si hebrenjtë, antifashistë në bindje, komunistët e një bote të re, kundërshtarët e tjerë politikë të regjimit nazist, arritën të ndërtonin deri aeroplanë lufte dhe pajisje të tjera ushtarake nëpër tunelet e thella që ata kishin ngritur po vetë.⁴⁰

Të burgosurit vendoseshin në barakat e ndërtuara që në fillimet e kampit. Një barakë kishte ndarje në dy dhoma: A dhe B. Çdo dhomë ndahej në dy pjesë: njera ku rrinin të internuarit dhe tjetra e fjetjes. Në mes ishte WC-ja. Shtretërit ishin prej druri me dy e tre kate. Në çdo krevat flinin tre veta në kushte tepër të vështira. Për mbulesë në dimër kishin një batanie të hollë. Dritaret dhe dyert qëndronin të hapura. Shumë ishin ata që vdisnin nga të ftohtit. Të sëmurët me sëmundje ngjitëse ishin në karantinë në katër baraka. Pranë ishte blloku vdekjes, që dikur shërbente si infermieri.⁴¹ Në gusht 1938, anëtarët e SS u transferuan nga kampi i përqendrimit Dachau në Mauthausen së bashku me të burgosurit e parë. Detyra e SS nuk ishte vetëm të ruante të burgosurit, por edhe të menaxhonte organizimin e brendshëm të kampit. Në krye të kampit SS ishte Komandanti (komandanti); me shumë pak përjashtime, i gjithë personeli i kampit ishte në varësi të tij. Komandanti i parë i Mauthausen ishte marangozi Albert Sauer. Në shkurt 1939 ai u zëvendësua si komandant nga Franz Ziereis, një ish -ushtar karriere. Ziereis ishte në krye të Mauthausen për gjashtë vjet, duke e bërë atë një nga komandantët më jetëgjatë të një kampi të vetëm përqendrimi. Ziereis dhe anëtarët e tjerë të SS u arratisën në fund të luftës, por ai u gjurmua dhe u plagos për vdekje gjatë shkëmbimit të zjarrit me ushtarët e ushtrisë amerikane. Para vdekjes së tij ai bëri një rrëfim të detajuar.⁴² Administrata e Kampit ishte përgjegjëse për të ashtëquajturën mbarëvajtje të kampit dhe ishte e ndarë në disa sektorë. Administrata përbëhej nga rreth 250-300 njerëz që punonin në gjashtë departamente të ndryshme:

- a- Komandanti i kampit dhe ndihmës
- b- Seksioni politik
- c- Kampi Mbrojtës i Kujdestarisë
- d- Administrata

⁴⁰Monika Stafa. Në Mathausen, historia dëshmon. E HËNË 18 KORRIK 2016, 15:03. DRITARE.NET

⁴¹Andrea Petromilo. Kujtesë e hidhur Mat'hauzen. Botimet Ymeraj, Vlorë, 2019, fq 65-70

⁴²<https://ëëë.mauthausen-memorial.org/en/History/The-Mauthausen-Concentration-Camp-19381945/Camp-SS-and-Guards>

- e- Seksioni Mjekësor
- f- Mirëqenia e Trupave dhe Udhëzimi Ideologjik⁴³

Një departament në dukje jo i rëndësishëm si “Mirëqenia e Trupave dhe Udhëzimi Ideologjik” por që në thelb ishte një nga instrumentet më të rëndësishme që kish përdorur regjimi nazist që në momentin që kish triumfuar në Gjermani sëbashku me Seksionin politik ishin baza ideologjike e administrimit të kampit. Në vendet totalitare propaganda dhe terrori paraqet dy anë të së njëjtës monedhe. Kudo që totalitarizmi zotëron kontroll absolut, ai zëvendëson propagandën me indoktrinimin dhe e përdor dhunën jo aq sa për të frikësuar njerëzit, sesa për të realizuar vazhdimisht doktrinat e tij ideologjike dhe gënjeshttrat e tij praktike.⁴⁴ Një vend të caktuar në regjimet totalitare zë propaganda. Fjalimet e mbajtura nga Hitleri para gjeneralëve të tij gjatë luftës janë modele të vërteta të propagandas, të karakterizuara kryesisht nga gënjeshttra monstruoze me të cilat Fyreri zbaviste miqtë e tij në një përpjekje për t’i mposhtur ata. Në thelb dominimi totalitar përpiqet t’i kufizojë metodat e propagandas vetëm ndaj politikës së jashtme apo ndaj degëve të lëvizjes jashtë për t’i furnizuar ato me material të përshtatshëm. Propaganda në fakt është pjesë e pandarë e “luftës psikologjike”, por terrori është edhe më tepër. Terrori përdoret në regjimet totalitare edhe kur synimet e tij psikologjike janë arritur; tmerri i tij i vërtetë është se ai sundon mbi një popullsi plotësisht të nënshtruar. Propaganda është një instrument dhe ndoshta më i rëndësishmi i totalitarizmit, për t’u lidhur me botën jototalitare, kurse terrori është vetë thelbi formës së tij të qeverisjes. Terrori si barasvlerës i propagandas, luajti një rol më të madh në nazizëm. Disa forma të terrorit qëpraktikoheshin në Kampin e Mauthausenit janë

- 1- Puna e detyruar në gurore
- 2- Eleminimi i të sëmurëve
- 3- Vrasjet masive të programuara
- 4- Puna e detyruar në fabrikën e armatimeve.

Në 1942, mbi 3,300 të burgosur punonin në guroret e kampit të përqendrimit në Mauthausen dhe Gusen. Ata punuan nën një SS-Kommandoführer (udhëheqës i njësisë SS të punës) dhe u mbikëqyrshin nga të burgosurit e tjerë, të njohur si Kapo. Përgjegjësit civilë ishin gjithashtu të punësuar në guroret e kampeve të përqendrimit dhe ishin përgjegjës për mbikëqyrjen e anës

⁴³<https://ëëë.mauthausen-memorial.org/en/History/The-Mauthausen-Concentration-Camp-19381945/Camp-SS-and-Guards>

⁴⁴ Hannah Arendt, *Origjinat e totalitarizmit*, Prishtinë, Dijsa, 2002, Fq. 441.

teknike të punës së të burgosurve. Për të burgosurit, dita e punës zgjati të paktën njëmbëdhjetë orë në verë dhe rreth nëntë orë në dimër. Ata punuan në të gjitha kohërat. Puna ishte rraskapitëse. Së pari të burgosurit duhej të thyenin blloqe guri nga shkëmbi me dorë ose duke përdorur eksplozivë. Pastaj ata duhej t'i copëtonin në copa më të vogla dhe t'i transportonin jashtë gurores.⁴⁵Dënimet më të rënda u jepeshin të internuarve që i rekrutonin në kompanitë e dënimit. Të burgosurit u caktuan në Strafkompanie (kompania penale) me pretekste të parëndësishme ose shkelje më të vogël të rregullave të kampit. Të qenit në kompaninë penale do të thoshte të mbanit blloqe graniti që peshonin deri në 50 kg në një kornizë druri në shpinë në vendet e ndërtimit në kamp. Marshimi deri në shkallët e gurores u shoqërua me rrahje nga rojet. Anëtarët e kompanisë penale zakonisht nuk mbijetuan gjatë. Në 1941 dhe 1942, hebrenjtë holandezë veçanërisht u shtynë drejt vdekjes mbi skajin e shkëmbit të guroreve nga SS-ët dhe Kapot, diçka e regjistruar në dokumentet zyrtare të kampit si "vetëvrasje duke kërcyer". Emri cinik i dhënë nga SS për të burgosurit e vrarë në këtë mënyrë ishte 'parashutistë'.⁴⁶Një dëshmitar okular dhe internuar në Mauthausen, Hamdi Tafizi nga Elbasani në dëshminë e vet botuar në gazetën "Bashkimi" në janar 1946 vetëm pak ditë pasi ishte kthyer në Shqipëri dëshmon se na ngarkonin me gure me nje peshe gjer me 40 kilogram. Duhet t'u ngjiteshim 186 shkalleve. Prapa na rrinte nje katil SS. Nese ndonje nga ne rrezohej gjermanet i bertisnin sabotator, bandit dhe e godisnin. Nje dite per kete arsye pushkatuan para syve tane nje francez nje holandez dhe nje çek. Na jepnin per te ngrene nje buke nente veta dhe nje liter supe per 24 ore. Flinim kater veta ne nje krevat, te mbuluar vetem me nje batanije. Çdo mengjes gjeje plot te internuar qe kishin vdekur. Mbi shtreterit vdisnin ne krahet e shoqeve te tyre.⁴⁷

Rajhu i III sipas teorisë raciste naziste nuk i nevojiteshin njerëzit e sëmurë dhe të dobët. Të ishe i sëmurë në Mauthausen ishte e barabartë me vdekjen. Shumica e të burgosurve të sëmurë rëndë u vendosën në Sonderrevier (kamp special) dhe më vonë në Sanitätslager (kamp infermierie). Të burgosurit të cilët ishin bërë të papërshtatshëm për punë gjatë sëmundjes, shiheshin si të padobishëm nga SS; vështirë se u ofrua ndonjë kujdes mjekësor për ta. Ata u keqtrajtuuan nga mjekët e SS për eksperimente mjekësore, u vranë me injeksion

⁴⁵<https://ëëë.mauthausen-memorial.org/en/History/The-Mauthausen-Concentration-Camp-19381945/Forced-Labour-in-the-Quarries>.

⁴⁶<https://ëëë.mauthausen-memorial.org/en/History/The-Mauthausen-Concentration-Camp-19381945/Forced-Labour-in-the-Quarries>.

⁴⁷Ja kush jane 48 shqiptaretqevdiqen ne kampin e Mathauzen. Gazeta Tirana Observer, 2009.

helmues ose në dhomën e gazit, ose u lanë në gjendje të mirë në zonat e izoluara të kampit.⁴⁸ Të tjerët që mendonin se ishin me më shumë fat se nuk po përdoreshin për eksperimente pësonin vdekjen e ngadalhtë nga të ftohti dhe uria. Në kampin special, një zonë e ndarë brenda kampit të të burgosurve, të sëmurët u lanë të vdisnin ose vdekja e tyre u përshpejtua duke zvogëluar racionet, duke i detyruar ata të qëndronin me të brendshme në oborr në të gjitha motet, ose duke i "mbuluar" me ujë të ftohtë dhe pastaj dërgimin e tyre të zhveshur në të ftohtë.⁴⁹

Një tipar tjetër i ushtrimit të drejtë për së drejtë të terrorit ishin vrasjet masive të programuara. Kampi i Mauthausen-it si një nga kampet më të hershëm i ndërtuar për të mbajtur të internuar kundërshtarët e rregjimit aplikoi disa procedura shkonin përtej poshtërimit dhe punës së detyruar. SS-ët dhe policia përdorën kampet e përqendrimit si vende ekzekutimi për kundërshtarët politikë që nga fillimi i luftës. Kjo zbatohet në masë të veçantë për kampet e përqendrimit Mauthausen dhe Gusen. Në vitin 1940, të dy u klasifikuan si kampet më të larta 'Klasa 3'. Këto ishin kampet që do të përdoreshin për të burgosurit e dënuar me kushtet më të rënda të burgut. Shumë u dëbuan në Mauthausen dhe Gusen thjesht për ekzekutim. Në Kampin e Mauthausen-it, pushkatimet fillimisht u bënë në vendin e ekzekutimit jashtë gardhit të kampit. Në fund të vitit 1941, një aparat për pushkatimin e të burgosurve në pjesën e pasme të qafës u instalua në bodrumin e krematoriumit. Kjo kishte për qëllim të thjeshtonte dhe racionalizonte procesin e ekzekutimit.⁵⁰ Nga muaji prill i vitit 1944 deri në 2 shkurt 1945 tek blloku i vdekjes u izoluan 4300 oficerë-rrobër rus, që nuk u regjistrua as emri i tyre e as iu vendos numër personal. Këta, herë pas here, individualisht ose në grupe, ekzekutoheshin me plumb pas kokës. Një, pjesë e tyre vdiq nga uria. Nga tërësia e tyre 600 por prej tyre u kapën 10 veta u pushkatuan.

Në Mauthausen ashtu si dhe në kampet e tjera të shfarosjes u instaluan dhomat e gazit që përmes të ashtëquajturës "koha për dush", viktimat ekzekutoheshin masivisht. Në vjeshtën e vitit 1941 filloi ndërtimi i një dhome gazi në Mauthausen dhe, në mars 1942, SS kryen vrasjet e para duke përdorur gaz helmues. Viktimat e para të dhomës së gazit ishin të burgosurit e luftës sovjetike të cilët ishin transferuar në kampin e përqendrimit Mauthausen për ekzekutim nga kampet e *Ehrmacht*-it për arsye politike. Më pas, dhoma e gazit u përdor kryesisht për

⁴⁸<https://ëëë.mauthausen-memorial.org/en/History/The-Mauthausen-Concentration-Camp-19381945/Murdering-the-Sick>.

⁴⁹<https://ëëë.mauthausen-memorial.org/en/History/The-Mauthausen-Concentration-Camp-19381945/Murdering-the-Sick>.

⁵⁰<https://ëëë.mauthausen-memorial.org/en/History/The-Mauthausen-Concentration-Camp-19381945/Rationalised-Mass-Murder>

vrasjen e grupeve të kundërshtarëve politikë dhe vetëm në një moment të mëvonshëm për shfarosjen e të burgosurve të sëmurë të kampit. Deri në fund të luftës, të paktën 3.500 të burgosur ishin vrarë në dhomën e gazit në Mauthausen.⁵¹

Kampi i dytë i barakave me numër 21-24 shërbente për strehimin e të internuarve të sapo ardhur. Në kampin e tretë të barakave, përbërë prej 8 të tilla, strehoheshin gratë, të cilat i sollën në verë të vitit 1944 nga Varshava. Nga vera e vitit 1944 deri në prill të vitit 1945 sollën këtu 3000 të internuar fizikisht të dobët, tek të cilët përdorën torturat më ç'njerëzore, kryenin pushkatime. Të pamundurit për të punuar i lidhnin pas murit dhe i linin të zhveshur në të ftohtë e në ngrica derisa jepnin shpirt. Nga gushti i vitit 1938 kur nisi funksionimi i kampit Mat'hauzen deri në 5 maj 1945 kur u çlirua kampi janë regjistruar 206000 të internuar. Nga ky numër mbetën të gjallë, sidomos ata që u sollën këtu kohët e fundit, 66534 (64800 meshkuj e 1734 femra). Kampi i Mauthausen-it kishte dhe nënkampet e tij në të cilat po njëjloj si në Mauthausen, jeta njerëzore sfidohej drejt vdekjes. Nuk ishin vetëm rojet e kampit dhe SS-ët që ushtronin dhunë mbi të burgosurit. Për të kontrolluar numrin e madh të të burgosurve, SS përdori të ashtuquajturat Funktionshäftlinge, ose funksionarë të burgosur. Ishte detyra e tyre të mbanin rendin në kamp. Në këmbim ata morën disa privilegje. Shumë u bënë agjentë të gatshëm të SS. Të tjerët gjithashtu përdorën pozicionin e tyre për të mbrojtur shokët e burgosur. Në krye hierarkia e të burgosurve ishte Lagerälteste (plaku i kampit). Ai ishte përgjegjës për SS për ruajtjen e rendit në të gjithë kampin. Nën atë ishin Blockälteste (pleqtë e bllokut), secila prej të cilëve kontrollonte një kazermë akomodimi. Lagerschreiber (nëpunësit e kampit) u punësuan nga SS për detyra administrative në kampin e të burgosurve. I ashtuquajturit Kapo ruante të burgosurit në punë. Në fillim, shumica e funksionarëve të burgosur ishin gjermanë dhe austriakë që ishin burgosur si kriminelë. Më vonë këto pozicione u mbushën gjithnjë e më shumë nga të burgosurit politikë dhe nganjëherë jo-gjermanë.⁵²

Nënkampin i Gusenit

Ky kamp u ngrit në dhjetor të vitit 1939 në një sipërfaqe 350m x 150m. Ishte rreth 4, 5 kilometra larg kampit qendror Mat'hauzen, ndërtuar pranë lumit Gusen, ujrat e të cilit derdhen në Danub. Në të u sistemuan dy grupe të internuarish: austriakë dhe gjermanë. Këta merreshin me ndërtime barakash. Kampi kishte 30 baraka të cilat mbaruan së mars të vitit 1940, u rrethuan me tela me gjemba, ku kalonte tensioni 300 volt. Në mars 1940 u sollën këtu

⁵¹<https://ëëë.mauthausen-memorial.org/en/History/The-Mauthausen-Concentration-Camp-19381945/Rationalised-Mass-Murder>

⁵²<https://ëëë.mauthausen-memorial.org/en/History/The-Mauthausen-Concentration-Camp-19381945/The-System-of-Prisoner-Functionaries>.

200 robër nga kampi i Mat'hauzenit si të sëmurë dhe nga kampi i Dahaut sollën 1080 polakë, që do të punonin në gurore. Një pjesë e robërve gjermanë u bënë bashkëpunëtorë të SS-ëve. Më pas sollën këtu 4000 intelektualë polakë, të cilët u torturuan. Më 9 mars 1944 u vu në funksionim nën kampi Gusen II me 10000 të internuar. Në dhjetor të vitit 1944 u vu në funksionim nënkampi Gusen III me 262 të internuar. Nga 1 tetori i vitit 1941 deri në maj të vitit 1942 u sollën në Gusen 2151 robër sovjetikë, të cilët punonin në miniera. Personat e dobët i pushkatonin. Baraka me numër 30 kishte të sëmurët me tuberkuloz, të cilët i vrisnin me gjilpërë në zemër. Kurse baraka numër 31 ishte e torturave. Nga 25 maj 1940 deri në 4 maj 1945 janë burgosur 67.677 të internuar. Prej tyre vdiqën 31.535 të rritur dhe 2500 fëmijë.

Nënkampi Ebesen

Ky nënkamp u hap me urdhër të Hitlerit më 22 gusht 1943. Tek ky kamp u grumbulluan të internuarit që punonin në armatime.

Nën kampin i Melkut

Ky nën kamp u hap më 11 prill 1944 dhe kishte 500 robër politik sovjetik, polak, italianë, hungarezë, grekë, jugosllavë, francezë dhe shfrytëzoheshin për hapjen e tuneleve, në të cilat do të vendoseshin fabrikat për prodhimin e armatimeve. Gjatë periudhës së funksionimit të këtij nënkampi vdiqën 5000 të internuar. Numri më i madh i të internuarve arriti 10352. Prej tyre mbetën gjallë 7478. Ky nën kamp u çlirua më 11 prill 1945.

Nënkampin i Buhenvaldit

Ky kamp u ngrit në Gjermani në vitin 1937. Sipas statistikave dokumentare janë vrarë e asgjësuar 32700 të internuar. Vetëm nga 01.01.1943 deri më 15.04.1944 këtu u asgjësuan 22781 të internuar.⁵³

Çlirimi i Kampit Mauthausen

Kampi i Mauthausen-it u çlirua më 5 maj 1945 kampit në Mauthausen iu afrua një skuadër Ushtarësh të Ushtrisë Amerikane të Skuadronit të 41 -të të Zbulimit të Divizionit të 11 -të të Armatosur të SHBA, Ushtria e 3 -të Amerikane. Skuadra e zbulimit drejtohej nga Rreshteri i Shtabit Albert J. Kosiek. Trupa e tij çarmatosi policët dhe u largua nga kampi. Deri në çlirimin e tij, shumica e burrave SS të Mauthausen kishin ikur tashmë; rreth 30 të tjerë që mbetën u vranë nga të burgosurit, dhe një numër i ngjashëm u vranë në Gusen II. Deri më 6 maj të gjitha nënkampet e mbetura të Mauthausen, me përjashtim të dy kampeve në Loibl Pass, u çliruan gjithashtu nga forcat amerikane. Komandanti SS i Kampit të Mauthausen-it

⁵³Andrea Petromilo. Kujtesë e hidhurMat'hauzen. BotimetYmeraj, Vlorë, 2019, fq 65-70

Franz Ziereis u arratis me gruan e tij më 3 maj 1945. Ai u përpoq të fshihej në shtëpizën e tij të gjuetisë në malin Pyhrn në Austrinë e Epërme. Atje ai u zbulua dhe u arrestua më 23 maj 1945, nga një njësi e ushtrisë amerikane. Ai u qëllua tre herë në stomak ndërsa po përpiquej të arratisesh dhe u dërgua në një spital ushtarak amerikan të ngritur në ish -kampin e përqendrimit Gusen I, ku ai vdiq menjëherë pas marrjes në pyetje nga një ish i burgosur i Mauthausen, Hans Marsalek. Kufoma e tij u var më vonë në gardhin e Gusen I nga ish të burgosurit e Gusen. Sipas Dr. Andreas Salmhofer, kërkues shencor pranë Memorialit të Mauthausen-it në Austri përafërsisht 167.000 të burgosur janë dokumentuar në data bazat e Memorialit. Midis 1938 dhe 1945, rreth 190,000 njerëz nga mbi 40 kombe të ndryshme u burgosën në kampin e përqendrimit Mauthausen/Gusen. Të paktën 90,000 prej tyre vdiqën në këto kampe. Ju lutemi vini re shënon Dr. Andreas Salmhofer, kërkues shencor pranë Memorialit të Mauthausen-it në Austri , kërkimet janë në vazhdim; numri i të dëbuarve dhe vdekjeve bazohet në nivelin aktual të njohurive dhe do të përditësohet vazhdimisht.⁵⁴

Enver Plepi një dëshmitar okular që vuajti dënimin në Kampin e Mauthausen-it kujton momentin e çlirimit të kampit. "Mbaj mend që kam dëgjuar gjallëri nëpër kamp. Unë isha aq i rraskapitur sa që mezi arrita të kuptoj se ç'po bëhet. Vetëm kuptoja Hitler kaput. Atëherë kemi dalë me këmbët që na merreshin nga dobësia e tepërt në oborrin kryesor. Këtu pamë me sy të shqyer një tank, mbi të cilin kishin hipur dy oficerë. E kuptuam se ishte tank amerikan, sepse shkruhej USA në një krah të tij. Doja të gëzohesha dhe të brohorisja për mua dhe për shokët, doja të ulërija nga gëzimi, porse nuk kisha fuqi. Ishim në një gjendje të çuditshme. Ishim si të dehur nga liria.⁵⁵ Ndër të burgosurit e çliruar nga kampi ishte toger Jack Taylor, një oficer i Zyrës së Shërbimeve Strategjike. Ai kishte arritur të mbijetonte me ndihmën e disa të burgosurve dhe më vonë ishte dëshmitar kyç në gjykimet e kampit Mauthausen-Gusen të kryera nga Gjykata Ushtarake Ndërkombëtare Dachau. Një nga të mbijetuarit e kampit ishte Simon Eiesenthal, një inxhinier që kaloi pjesën tjetër të jetës së tij duke gjuajtur kriminelët nazistë të luftës. Fituesi i Medaljes së Nderit në të ardhmen Tibor "Ted" Rubin u burgos atje si një adoleshent i ri; një hebre hungarez, ai u zotua se do të bashkohej me Ushtrinë Amerikane pas çlirimit të tij dhe më vonë bëri pikërisht atë, duke u dalluar në Luftën e Koresë si trupor në Regjimentin e 8 -të të Kalorësisë, Divizioni i Parë i Kalorësisë. Francesc Boix, një fotograf dhe veteran i Luftës Civile Spanjolle, u burgos në kamp për katër vjet. Gjatë kohës që punonte në laboratorin e fotografisë të kampit, ai arriti të nxjerrë 3,000

⁵⁴ Email nga Dr. Andreas Salmhofer, kërkueshencor pranë Memorialit të Mauthausen-it në Austri, dt 29 korrik 2021.

⁵⁵ Fatos Baxhaku. Aferdhelarg. Rrëfimet e durrsakut, qëmbijetoinë Mauthausen. G. Shqip, 08/04/2007.

negativë jashtë kampit dhe më vonë e përdori këtë dëshmi fotografike për të dëshmuar në gjykimet e Nurembergut.

Qyteti i Nurembergut vendi ku kishte filluar triumfi nazist u shndërrua në qytetin simbol ku u zhvillua tribunali ndaj errësimit të arsyes njerëzore. Në qytetin buzë lumit Pegnitz, në Nuremberg të Bavarisë, Gjermania Jugore, atje ku në vitet 1930 mbaheshin kongreset e Partisë Naziste dhe mitingjet e mëdha të përvitshme të Partisë Naziste, më 1945-'46 u zhvilluan gjyqet e Nurembergut, në të cilat kriminelët nazistë të luftës u gjykuan nga një gjykatë ndërkombëtare ushtarake. Gjyqi i Nurembergut ishin një seri gjykatash ushtarake të mbajtura pas Luftës së Dytë Botërore nga Forcat Aleate, sipas ligjit ndërkombëtar dhe ligjeve të luftës dhe u bënë për ndjekjen penale të anëtarëve të shquar të udhëheqjes politike, ushtarake, gjyqësore dhe ekonomike të Gjermanisë naziste, të cilët planifikuan, kryen masakra e morën pjesë në Holokaustin dhe krimet e tjera të luftës. Gjyqet u mbajtën në Nuremberg të Gjermanisë dhe vendimet e tyre shënuan një pikë kthese midis ligjit klasik dhe atij ndërkombëtar bashkëkohor, sepse siguruan një platformë për drejtësi kundër kriminelëve të luftës naziste të akuzuar. Përpjekja e parë për të ndëshkuar autorët u krye nga Tribunali Ushtarak Ndërkombëtar (IMT) në qytetin gjerman të Nurembergut, duke filluar më 20 nëntor 1945. Në gjyq ishin 24 kriminelët më të mëdhenj të luftës të Gjermanisë naziste, përfshirë Hermann Goering, Martin Bormann, Julius Streicher dhe Albert Speer. Pas Çlirimit të Europës, Gjyqi i Ushtrisë së Trupave Aleate të Nurembergut përfundimisht, dënoi me vdekje 12 kriminelët nazistë. Kështu që termi “gjykim i Nurembergut” përfundimisht përfshiu këtë gjyq origjinal të liderëve nazistë, si dhe 12 gjykime pasuese që zgjatën deri në vitin 1948.

Kthimi i të mbijetuarve

Të internuarit shqiptarë vuajtën kryesisht në Kampin e Mauthausen-it. Sipas statistikave të memorialit të Kampit Mauthausen aty kanë vuajtur 161 persona nga Shqipëria ose me prejardhje shqiptare që u burgosën në Mauthausen ose nënkampet, 112 prej tyre vdiqën ose u vranë, 42 prej tyre mbijetuan dhe 7 prej tyre u transferuan nga Mauthausen ose nënkampet në kampe të tjera përqendrimi. Katër shqiptarë janë dokumentuar online në “dhoma e emrave”, ku mund të gjenden fotografi të të burgosurve shqiptarë. Ata janë: Vangjel Shkurti (1884 – 1944) Xhemal Myhyrdari(1908 – 1945), Kozma Nushi(1909 – 1945), Xhevdet Doda(1906 – 1945).⁵⁶

⁵⁶Email nga Dr. Andreas Salmhofer, kërkueshencor pranë Memorialit të Mauthausen-it në Austri, dt 29 korrik 2021.

Ndërkohë arkivat shqiptare japin shifra deri në 423 viktime çka dëshmohet edhe nga një pllakë përkujtimore e vendosur në Memorialin e Mathausen-it. Ata janë: Xhevdet Doda, Kozma Nushi (Hero i Popullit), Abaz Dine, Abaz Sullaj Abdulla Tabaku, Adil Alushi, Ahmet Ramzoti, Alem Tafili, Ali Ashimi, Alim Biduli, Asti Gogoli, Azem Toska, Bedri Agalliu, Beg Nushi, Besim Liku, Buharedin Mitaraj, Cane Çaçi, Cane Rapushi, Dalip Meminaj, Demir Bardhi, Dervish Hoxha, Dilaver Kamberi, Dhimitër Konduri, Dhimitër Kulla, Ejup Kondo, Emanuel Hazdurian, Enver Velaj, Faik Haruni, Faslli Lelaj, Faslli Zogaj, Feim Mustafaj, Fejzo Toska, Ferik Buzi, Fizo Spahiu, Gani Kokli, Gjysh Duraj, Hajdar Shameti, Hajredin Kërkova, Hakim Veliu, Halil Shyri, Hamit Roseni, Hamit Xhyheri, Hamza Laperi, Hasan Doci, Heruran Novruzi, Hysen Shtufi, Ibrahim Skëndaj, Ibrahim Xhatufa, Ilo Çomi, Isa Rapushi, Ismail Zyma, Isuf Berberi, Isuf Ibërshimi, Izet Mema, Jani Kosta, Jani Nathanaili, Jani Popa, Jano Maska, Jorgji Ziu, Koro Çoni, Kostandin Simaku, Late Bregu, Mehmet Dauti, Mehmet Sulo, Mihal Koçi, Mihal Pema, Minella Gogo, Muhamed Velaj, Muhamet Bino, Muhamet Dine, Muhamet Kabashi, Musa Gorishti, Mustafa Kotherja, Mustafa Zahaj, Myslym Nelaj, Mustehat Malaj, Naun Thanasi, Neim Gjoni, Nexhip Hekurani, Nexhip Himçi, Nevruz Abazi, Nevruz Dine, Nevruz Hajdini, Nuredin Memishaj, Pandeli Dimo, Perikli Papingji, Piro Papalilo, Qazim Çakërri, Ramadan Nebiu, Ramadan Ramo, Ramazan Myrto, Rapo Kapllani, Rapush Çarçani, Rasim Hamzaraj, Refat Ismajli, Rexhep Bani, Sabri Habibaj, Sadik Asnjoku, Sali Dibra, Sami Karriqi, Selim Çarçani, Senusi Nota, Sofokli Dhimiatiadhi, Stavri Havale, Sulejman Cenoimeri, Sulejman Doko, Sulejman Rukja, Sulejman Zakja, Sulo Gorishti, Shefqet Leka, Shefqet Shyti, Sherif Nuredini, Shyqyri Buzi, Taqo Dino, Tefik Skilja, Telat Noga, Teme Alushi, Thimio Nathanaili, Thoma Kuqali, Vangjel Vasili, Vangjel Shkurti, Vangjel Xhani, Vasil Dushku, Vasil Gjata, Vasil Mojsiu, Vehbi Vreshtazi, Xhafer Kodra, Xhafer Skilja, Xhemil Kasa, Xhemal Myhdari, Xhemal Shasho. Në listën e shqiptarëve që kanë vdekur në kampin e Mathausenit, ku shënohet numri personal, emri dhe datëlindja janë: Athanas Babe, Andro Gerverni, Abdullah Kinetani, Ajaz Arifi, Anasatas Stavro, Ahile Lito, Bedri Agalliu, Besim Liku, Çako Lamani, Dervish Troka, Ded Papa, Sofokli Dhimitriadhi, Estref Fiaq, Fejza Dino, Gani Begosali, Georgi Cin, Hajredin Hazdinaj, Hazbi Bani, Habib Koka, Halem Telfaj, Halil Aliti, Ibrahim Gunardhi, Istref Dekollari, Jakup Telfaj, Jani Goda, Fadil Alushi, Kosta Mani, Kostandin Semikiç, Lefter Bezhani, Musten Gunbardhi, Miho Çiko, Mihal Shyti, Moikom Shyti, Naqo Siko, Nikolla Çika, Niko Papalilo, Lilo Palla, Ilija Vimo, Perikli Papingji Qazim Çakërri, Qemal Muhedari, Ramazan berberaj, Ramazan Armeni, Rushit Vërzhezha, Rexhep Toto, Muzafer Velaj, Nazif Spani, Rapo Ruçi, Rukije Sulejmani, Refat Sedrioviç, Rahman Hysa, Refit

Mustafaj, Farudin Rustemi, Skënder Vrenaraj, Selfo Shebaj, Sulejman Seferi, Selim Begaj, Sofokli Dimi, Seit Qemali, Shezai Qemali, Shefqet Suli, Shahin Alia, Shyqyri Tare, Zoga Falre, Taqi Poliçani, Vangjel Xhema, Thoma Karagjozi, Qerim Asimi, Kristofor Gjyli, Stefan Sotiri, Nasim Gjani, Tahsim Jonuzi.⁵⁷

Nga një identifikim i kujdesshëm i emrave të gdhëndur në pllakën përkujtimore rezulton se ka dhe emra të personave që nuk kanë vdekur në Kampin e Mauthausen-it por në Ohër dhe Manastir apo dhe në kampet e Banicës dhe Zemunit. Në një nga dëshmitë e para të mbledhura menjëherë pas luftës botuar në gazetën "Bashkimi" vetëm pak ditë pasi ishte kthyer në atdhe në janar të vitit 1946, Hamdi Tamfizi dëshmon për vdekje të shumta të shkaktuara gjatë transportit të të burgosurve nga Shqipëria drejt Kampit të Mauthausen-it. Me perpara e shpune në policinë e Elbasanit, bashkë me Gafur Gjaten, Gani Koklin dhe Jovan Tonen. I futën në burgun e ballistëve ish-komandant Xhaf Bali, pasi u morën kepuçet dhe pantallonat. Pastaj i dorezuan të gjermanet, të cilët i mbajtën një ditë në burgun e tyre, dhe së bashku me grupe të tjera të ardhur nga Korça, nga Vlora, nga Durresi dhe nga Kavaja, i hipën në makinë dhe i nisën për në Manastir. Ishin gjithsej 250 vete. Nga Manastiri i nisën në Shkup, dhe prej atje në Zemun. Në Zemun, tregoi Hamdiu, gjetën shumë vlonjëta që ishin dërguar atje gjashtë muaj më përpara. Në fillim, siç na thanë, ishin 135 vete, por kur vajtimet gjetëm vetëm 9 vete. Të tjerët kishin vdekur nga uria dhe ishin pushkatuar nga gjermanët dhe çetnikët.⁵⁸ Kthimi i të burgosurve shqiptarë në atdhe kaloi një kalvar tjetër peripecish pasi Evropa sapo kishte dalë nga lufta. Për ne kujton ish borgosuri Enver Plepi filloi trajtimin special në disa kampe të ngritura nga aleatët. Pak nga pak nisëm të marrim veten. Në korrik të 1945 mund të merrja rrugën e kthimit. Amerikanët na pajisën me disa karta të posaçme, me të cilat mund të udhëtonim e të ushqeheshim. Kemi kaluar në fillim në Budapest e më pas në Beograd, prej këtej në Shkup dhe më pas drejt shtëpisë në Durrës. Kur kam mbërritur në Durrës, më dukej si një gjë e pabesueshme. Nuk e njoha time më, as ajo mua. Të dy kishim ndryshuar aq shumë nga kjo histori e rëndë. Bashkë me mua u kthyen edhe 14 të mbijetuar të tjerë. Shokë të tjerë, si Beqir Xhepa u kthyen nga ana e Italisë. Kishim qenë 440 shqiptarë në Mauthausen, kishim shpëtuar vetëm 23. 19 prej të mbijetuarve ishim nga Durrësi dhe Tirana. Patëm vetëm fat. Asgjë tjetër përveç tij".⁵⁹ Shifra që jep dëshmitari Enver Plepi që më vonë ka qenë një aktivist i Komitetit të Mauthausen-it të formuar në Shqipëri pas ndërtimit të Memorialit të Mauthausen-it dhe përkujtimit të vuajtjeve të shqiptarëve aty është një shifër që

⁵⁷Pllaka e gdhëndur në Memorialin e Mauthausen-it në Austri

⁵⁸Ja kush janë 48 shqiptarët që vdiqën në kampin e Mathauzen. Gazeta Tirana Observer, 2009.

⁵⁹Fatos Baxhaku. Aferdhelarg. Rrëfimet e durrsakut, qëmbijetoi në Mauthausen. G. Shqip, 08/04/2007.

duhet të përfshijë shtetas shqiptarë nga Vlora, Durrësi, Korça, Elbasani, Kavaja por edhe Kukësi e Tropoja. Një dëshmi tjetër e dhënë nga Tafil Sinovarfi nga fshati Kuç i Vlorës jep një numër tjetër të mbijetuarish nga Kampi i Mauthasen-it. Dhe një ditë erdhi sihariqi. Kampin do ta merrnin në dorëzim Aleatët, sepse Nazizmi kishte rënë. Domosdo, gëzimi ishte i pakufi, por edhe torturat nga më të mëdhatë, sepse bishat që na kishin në dorë sikur shfrytëzonin minutat për të na torturuar më tepër. Sidoqoftë u dhanë shenjat e vazhdimit të jetës. Na grupuan sipas kombësive dhe asisoj morëm vesh që ishim 96 shqiptarë. Na ngritën edhe flamurin kombëtar pranë sektorit ku ishim ne. Na informuan për familjet dhe njoftimin se ua kishin dhënë sihariqin atyre që ne jemi gjallë. Mbi të gjitha se së shpejti do të ktheheshim në Shqipëri. Nëpërmjet organizimit të tyre, Aleatët, në kushte krejt të tjera, na sollën në Jugosllavi ku u bashkuam me forcat e Br.6 S që në atë kohë vepronte në Kosovë për çlirimin e saj. Nga aty na sollën në Gjirokastrë, duke na pritur kuadrot drejtuese të këtij rrethi, të cilët na uruan që u kthyem gjallë dhe na përgëzuan për qëndresën, guximin dhe dinjitetin e treguar. Më pas, po në Gjirokastrë, u takuam me familjet tona, që gjithashtu kishin ardhur aty për të na pritur. A mund të imagjinohen emocionet e dyanshme të atij takimi, kur për gjithë atë kohë kishim qenë në “listën” e të vdekurve?!⁶⁰Përsa i përket viktimave informacioni më i hershëm vjen nëpërmjet Kryqit të Kuq dërguar në Shqipëri dhe botuar në gazetën “Bashkimi” në janar 1946 ku jepen emrat e 48 personave.

1. Ali Akin
2. Fadil Alushi
3. Emanuel Andourian
4. Asim Qerim
5. Athanas Babe
6. Bedri Agolli
7. Selim Begaj
8. Gani Bejgosaj
9. Ibrahim Rexhepi
10. Cane Cace

⁶⁰Dervish Kondi. Katërkuçiotët e Mat’hauzenit. Gazeta Telegraf 16 Shtator, 2013.

11. Miho Ciko
12. Istref Dekollari
13. Dhimitriadhi Sofokli
14. Dhimitri Kosta
15. Sabri Dino
16. Xhevdet Dino
17. Vasil Dushku
18. Meship Himçi
19. Xhafer Kodra
20. Dhimitri Kondiu
21. Bislim Kortesoviç
22. Vlash Kuko
23. Ahile Lita
24. Shefqet Leka
25. Izet Memsi
26. Myzafer Velaj
27. Xhemal Myhredari
28. Siko Nago
29. Narfi Kapohi
30. Thimio Nathanail
31. Kozma Nushi
32. Taqi Poliçani
33. Imer Rexhepi

34. Sulejman Rukja
35. Fahrudin Rustemaj
36. Rifat Sadrioviq
37. Jani Kariqi
38. Hajdar Shameti
39. Kostandin Simokiq
40. Ibrahim Skendaj
41. Xhaferr Skilja
42. Abdulla Tabaku
43. Halem Tafilaj
44. Tefik Skilja
45. Naum Thanasi
46. Vimo Ilija
47. Skender Vranoraj
48. Hamit Xhyheri.

Shteti shqiptar i porsa dalë nga lufta pas kërkesave të shumta të shtetasve të vet për arrestimet dhe dërgimet në Kampet e Përqëndrimit ndërmorri disa hapa të rëndësishëm për identifikimin dhe riatdhesimin e të shpëtuarve. Pozita ndërkombëtare e Shqipërisë menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore ishte shumë e dobët dhe aleati i vetëm në të cilin ajo mbështetej ishte Jugosllavia e re e Titos. Menjëherë pas çlirimit të vendit filluan të dalin në pah synimet e komunistëve shqiptarë me Enver Hoxhën në krye për të ecur përkrah Jugosllavisë së Titos deri në bashkimin me të në Konfederatën Ballkanike. Për këtë arsye, Enver Hoxha kishte përkrahjen e të dërguarve të Beogradit (p.sh., Velimir Stojnić në Plenumin II të Beratit Tetor 1944). Në plenumin V të KQ të PKSH (shkurt 1946) Enver Hoxha tha: “Nuk e kemi drejtuar popullin tonë sa duhet drejt vëllazërimit të shëndoshë me Jugosllavinë, që është një konditë e domosdoshme për ekzistencën e vendit tonë”, madje lexoi po aty direktivën: “të luftojmë me

mish e me shpirt tendencat shoviniste të atyre shqiptarëve që luftojnë të ngjallin mërinë e vjetër kundër popujve të Jugosllavisë". Tendencat e para të një lloj protektorati jugosllavët i shprehën në mënyrë të hapur dhe shtetërore që në ndërtimin e shtetit të ri shqiptar. Institucionet kryesore u vendosën nën një diktat dhe këshillim të drejtpërdrejtë të këshilltarëve jugosllavë, që ishin atashuar pranë çdo dikasteri të rëndësishëm. Kryeministria, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit sipas dokumentacionit përkatës korrespondojnë dhe raportojnë në Beograd, duke vazhduar një traditë që kishte filluar që gjatë luftës. Të gjitha vendimet kryesore të politikës së jashtme dhe të brendshme të qeverisë shqiptare merreshin me dijeni dhe në bashkëpunim të plotë me autoritetet jugosllave në Beograd, duke krijuar de facto tiparet e një shteti nën protektorat. Në këtë kontekst përfaqësimin diplomatik të shqipërisë në vendet ku nuk kishte përfaqësi diplomatike sipas marrëveshjes midis dy shteteve e kishte marrë përsipër Jugosllavia. Përveç çështjeve të përfaqësimit diplomatik shteti jugosllav mori përsipër edhe kërkimin dhe riatdhësimin e të burgosurve shqiptarë në kapet e përqindrimit. Pas një kërkesë të qeverisë shqiptare në datën 29 shtator 1947, një ditë më vonë Ministri Fuqiplotë Tuk Jakova në Beograd raporton në Ministrinë e Punëve të Jashtëme të Shqipërisë:

Përgjigje shkresës t'uaj Nr. B.IV.819 Rez datë 24.9.1947.

Qeveria Jugosllave na jep gjithë ndihmën e saj për gjetjen e t'interuarve Shqiptarë. Mundësitë e gjetjes ku janë më të mira, ku ka më shumë pengesa. Ministrija do udhzojë Perfaqësitë e tyre. Ato do mbledhin informata dhe do të na i dërgojnë. Se si i kanë gjetur Jugosllavët? Kjo varet sipas konditave të Terenit. Mënyrat nuk janë njësoj si dhe vështirësitë s'kanë qenë njësoj. Sidoqoftë kjo barë është kryer nga Përfaqësitë Diplomatike dhe Ushtarake.⁶¹

Si rezultat i këtij përfaqësimi legatat jugosllave filluan kërkimin dhe identifikimin e shtetasve shqiptarë në Evropë. Në një raport të legatës jugosllave në Shqipëri të datës 23 janar 1948 dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë lexojmë: Për dijeni dhe kompetencë ju përcjellim këtundgjatur, 6 raporte mbi vdekjen e gjashtë Shtetasve shqiptare në fushën e përqëndrimit të Mauthausen në Gjermani. Raportet të shkruara në gjuhën gjermane, na janë dërguar prej Legatës të R. F. P. të Jugosllavis në Tiranë dhe u përkasin këtyre personave.

⁶¹ MEPJ ARKIV, VITI 1948, DOSJA:74 , FLETA, 47

- 1) Selfo Shabaj, nga Vlora
- 2) Ajas Arif nga Korça
- 3) Jani Nathanaili, nga Delvina
- 4) Rushit Vehi Vreshrati, nga Vlora
- 5) Istref Fico, nga Gjinokastra
- 6) Thoma Karagjozi, nga Vlora.⁶²

Emrat e këtyre personave janë të komfirmuar dhe në listat e mëvonshme dhe në atë që gjendet në Memorialin Mauthausen në Austri. Dokumenti më i rëndësishëm i kësaj periudhe është një listë me 227 shtetas shqiptarë që rezultojnë të arrestuar dhe internuar nga autoritetet gjermane të pushtimit që Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë i dërgon legatës shqiptare në Beograd. Bashkalidhur me listën në shkresën përcjellëse citohet lista përmban gjithë informacionin që disponon shteti shqiptar.

Bashkëngjitur ju dërgojmë 9 copë lista që përmbajnë 227 shtetas shqiptarë, t'internuar nëpër vende të ndryshme nga nazifashistët gjat kohës së okupacionit, që akoma nuk janë kthyer në atdhe dhe që familjet e tyre nuk kanë ndonjë njoftim rreth fatit të tyre. Në listat që ju dërgohen janë shënuar gjithë gjeneralitetet dhe shënimet që disponojnë autoritetet t'ona kompetente. Lutemi të ndërmjetësoni pranë Ministrisë P. Të jashtme t'atyshme me qëllim që mundësisht organet e tyre të interesohen në Gjermani mbi fatin e këtyre personave duke u bazuar në dokumentet e fushave të përqëndrimit ose në informata të tjera që mund të marrin mbi ta.

Lutemi na njoftoni përfundimin.⁶³

Pas prishjes së marrëdhënieve të ngushta politike midis Shqipërisë dhe jugosllavisë pas rezolutës së ImfoByrosë në 29 qershor 1948, K.Q. i P.K.SH. publikoi komunikatën, me të cilën solidarizohej me rezolutën e Byrosë Informative "Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave", ku dënohej rruga e P.K.J. dhe e udhëheqjes së saj brenda kampit socialist. Më 1 korrik 1948, qeveria shqiptare i dërgoi një notë zyrtare Jugosllavisë, me anën e së cilës e njoftonte për ndërprerjen e të gjitha marrëveshjeve dhe konventave ekonomike midis dy

⁶² MEPJ ARKIV, VITI 1948, DOSJA: 74 FLETA 34

⁶³ MEPJ ARKIV, VITI 1948, DOSJA: 74, FLETA, 36

vendeve. Po kështu, qeveria shqiptare anulonte të gjitha marrëveshjet dhe konventat ekonomike të nënshkruara pas datës 9 korrik 1946, datë në të cilën ishte nënshkruar në Tiranë, Konventa për Miqësi e Bashkëpunim Reciprok midis qeverisë shqiptare dhe asaj jugosllave. Në mes këtyre marrëveshjeve u prish dhe marrëveshja për autorizimin e Jugosllavisë për gjetjen e shtetasve shqiptarë të vdekur dhe internuar në kampet e përqëndrimit. Në një dokument në Arkivin e MEPJ të Shqipërisë citohet: Njoftoni Qeverinë Jugosllave me anë të një Note se Qeverija Shqiptare i heq të drejtën e kërkimit të internuarve Shqiptar në Gjermani – Austri mbasi nuk e shikon të nevojshme një gjë të tillë. Njëkohësisht shtoniqë Qeverija Jugosllave të njoftoj Komandën Aleate në Berlin mbi pushimin e këtij veprimi. Më vonë ju dërgojmë një Notë për Ambasadën Poloneze ku i jepet e drejta e kërkimit të shqiptarve të internuar Qeverisë Poloneze.⁶⁴ Pas marrjes së përfaqësimit nga qeveria polake kërkesat u intensifikuan dhe me ndihmën e qeverisë sovjetike. Në një dokument të të MEPJ të datës 22 dhjetor 1948, i nënshkruar nga ambasadori shqiptar Mihal Prifti në Moskë citohet

Për sa kërkohej në shkresën e sipërme Ministrija P.Jashtme të BRSS na u përgjegje se çështje e 227 t'internuarve Shqipëtar në Gjermani gjat luftës i asht parashtruar Seksionit Ripatrimt dhe kërkimit të njerëzve në UNO prej administratës Ushtarake Sovjetike në Gjermani. Seksioni Ripatrimt dhe kërkimit ka lajmëruar se kërkimi për Shqipëtarët në fjalë deri më tani nuk ka patur ndonji rezultat. Seksioni lajmëroj gjithashtu se kërkimi vazhdon nga zyrat Amerikane, angleze dhe Franceze dhe në rast të ndonji rezultati mbi këtë çështje do të vihemi në korent në mënyrë të plotë.⁶⁵

Një kapitull i ri i jetës ishte hapur për të rikthyerit shqiptarë nga Kampi i Përqëndrimit në Mauthausen, Austri. Periudha e rinteprimit të tyre në shoqëri do të ishte e vështirë dhe do të kalonte përmes disa etapave që do linin shenja në jetën e tyre. Në Shqipëri ishte instaluar një diktaturë e re e ekstremt të majtë që nëpërkëmbte shprehjen e mendimit të lirë dhe si gjithë regjimet totalitare ndërmerre masa shtypëse ndaj lirisë individuale të shtetasve të vet.

Rehabilitimi në shoqërinë totalitare komuniste

Për pjesën më të madhe të të ish dënuarve të ardhur nga Kampi i Përqëndrimit të Mauthausen-it rinteprimi i tyre në shoqërinë shqiptare rezultoi të ishte në fillim një rinteprim i natyrshëm. Pjesa më e madhe e tyre kishin qenë pjesëmarrës të rezistencës dhe falë lidhjeve

⁶⁴ MEPJ ARKIV, VITI 1948, DOSJA:74 , FLETA, 48

⁶⁵ MEPJ ARKIV, VITI 1948, DOSJA:74 , FLETA, 46

personale në qytetet e lindjes apo dhe strukturës së shoqërisë shqiptare të mesit të shekullit të XX e rigjetën veten shpejt në mekanizmat e shtetit të ri shqiptar. Për më tepër ata që kishin besuar në idealin e ndërtimit të një shoqërie të re bazuar në botëkuptimin e tyre komunist gjetën një rrugëdalje kur u kthyen në ruajtjen e kthjelltësisë së mendjes përmes synimit të tyre për të ardhmen. Gati të gjithë të mbijetuarit e kësaj kategorie rrëfejnëse mbijetuan falë idealit të tyre dhe bisedave me shokët për të ardhmen e vendit.

Gjithësesi deri më tani mungon një analizë shteruese për efektet psikologjike të rifitimit të lirisë si përshkruan i mbijetuari i kampit të Aushvicit, Viktor E. Frankl në librin e vet “Në kërkim të kuptimit të jetës”. Nga ana psikologjike shkruan Frankl, ajo që po ndodhte me të burgosurit e liruar mund të quhej “depersonalizim”. Çdo gjë dukej e pagjasë e si nëëndërr. Nuk besonim se ishte e vërtetë, sepse në të shkuarën ishim zhgënjyer kaq shumë nga ëndrrat. Kishim parë nëëndërr ditën e parë të lirisë, kishim parë nëëndërr lirim tonë, kthimin tonë në shtëpi, përshendetjen me miqtë, përqafimin e grave tona, ishim shtruar dhe në tryezë e patëm rrëfzer të gjitha ato që patëm hequr, madje kishim rrëfyer edhe sa shpesh e patëm parë nëëndërrat tona ditën e lirim! Dhe pastaj na kishte hedhur përpjetë një vërsëllimë metalike që të shponte veshët: sirena e zgjimit që u jepte fund ëndrrave tona. Si mund ta besonim tani që ëndrra doli e vërtetë?⁶⁶ Shoqëria patriakale shqiptare e bazuar mbi mbarëvajtjen e një ekonomie shtëpiake e mbi ndarjen e barabartë të krahëve të punës nuk kishte shumë hapësira për një trajtim të specializuar të të rikthyerve nga kampet e përqëndrimit. Tmerret e zhvillimit të luftës, mungesa e ushqimit apo qoftë dhe marshimet rraskapitëse të anëtarëve të forcave të rezistencës nuk mund të barazoheshin me vuajtjet në kampet e përqëndrimit. Për shumë ish të burgosur si shpreht Frankl hidhërimi shkaktonte nga një numër gjërash që ndeshnin në qytetin e tyre të dikurshëm. Kur i burgosuri kthehej në qytetin e vet dhe vinte re se në shumë vende që shkonte e prisnin me një ngritje supesh dhe me fraza bajate, ai hidhërohej dhe pyeste veten përse i kishte hequr gjithë ato vuajtje. Kur dëgjonte thujase kudo të njëjtat fraza: “Nuk dimë gjë për të” apo : “Edhe ne kemi vuajtur”, ai pyeste me vete: Vërtet nuk paskan asgjë më të mirë për të thënë?⁶⁷.

Një pjesë e të burgosurve shqiptarë falë lidhjeve të forta familjare që egzistonin në shoqërinë shqiptare gjetën ngushëllim e strehë për të mbijetuar pikërisht tek dashuria për familjen. Në radhë të parë shprehet i mbijetuari Abdulla Krutani në intervistën e tij të fundit njeriu duhet të ketë kurajo në vetvete. E dyta, gjithmonë duhet ta mbajë mendjen tek e mira, jo tek e keqja”.

⁶⁶Viktor E. Frankl. “Në kërkim të kuptimit të jetës” Botimet “Gumeni”, Tiranë, 2007, fq 129

⁶⁷Viktor E. Frankl. “Në kërkim të kuptimit të jetës” Botimet “Gumeni”, Tiranë, 2007, fq 133

Pyetjes se ku e mbante mendjen gjatë kohës së internimit Abdulla Krutani iu përgjigj: Tek familja në radhë të parë, tek nëna ime (përlotet)vëllai, motrat. Gjithmonë më dilnin para syve. Me kurajo të madhe i jepja vetes shpresën e shpëtimit dhe mbarimit të luftës”.⁶⁸

Por integrimi në një shoqërit totalitare që cdo ditë e më tepër po hidhte shtat në Shqipëri rezultoi i vështirë për një kategori tjetër ish të burgosurish të Kampit të Mauthausen-it edhe pse në fillim ata u integruan në mekanizmat shtetërore. Komunizmi shqiptar ishte një derivat i komunizmit sovjetik i pajisur me asistencë dhe ndihmë jugosllave. Terrori përdoret në regjimet totalitare edhe kur synimet e tij psikologjike janë arritur; tmerrri i tij i vërtetë është se ai sundon mbi një popullsi plotësisht të nënshtruar. Propaganda është një instrument dhe ndoshta më i rëndësishmi i totalitarizmit, për t’u lidhur me botën jo totalitare, kurse terrori është vetë thelbi i formës së tij të qeverisjes. Por, a është terrori në vetvete një tipar i komunizmit? Sigurisht që zhvillimet e mëvonshme e kanë saktësuar këtë dilemë. Komunizmi dhe fashizmi si pjesë të ideologjive totalitare apo murtajave të shekullit, siç i vlerësuan mendimtarë të mëvonshëm, ushtruan terror për të realizuar qëllimet e tyre të inxhinierive sociale. Qëllimi i terrorit është të ngjallë frikë në masën e gjerë të popullsisë. Regjimi totalitar komunist prodhon armiq, ndaj të cilëve merren masa shtrënguese, shtypëse, represive deri në likuidimin fizik. Për regjimet komuniste armiqtë janë klasa e borgjezisë, e çifligarëve, imperialistët, të cilësuar si klasa shtypëse e shfrytëzuese, armiq të proletariatit dhe të fshatarësisë. Në komunizëm “lufta e klasave” trajtohet dhe cilësohet si forcë lëvizëse për të gjithë periudhën e transformimit të shoqërisë. Pra, gjatë gjithë periudhës së socializmit e të kalimit në komunizëm kërkohen dhe zbulohen armiq të rinj Totalitarizmi komunist ka këto tipare:

1-Ideologjia e vetme sunduese ose ideologjia totalitare. Ato kanë si karakteristika kryesore: Ideologjia marksiste konsiderohet si udhëheqëse në të gjitha aspektet e qeverisjes e veprimtarisë publike dhe private; ajo është e detyrueshme për të gjithë individët. Ajo cilësohet si botëkuptim i gjithanshëm, që përshkon dhe mishëron gjithçka. Ideologjia paraqitet si platformë e “së ardhmes” e ndërtimit të “shoqërisë së re” e të “rendit të ri”. Nuk lejon ideologji apo alternativa të tjera. **2-Ekzistenca e një partie të vetme;** parti-shtet. Partia vendos monopolin në drejtimin e vendit dhe të të gjitha hallkave të qeverisjes, prandaj qeverisja cilësohet si parti shtet; Likuidohet konkurrenca politike, opozita politike. **3-Kulti i udhëheqësit.** Udhëheqësi është ai që përcakton zhvillimin dhe çdo gjë i nënshtrohet

⁶⁸JonidaHitoveizi. Abdulla Krutani, imbijetuariifunditi “Mauthausen” qëishpëtoikrematoriumit. Dritare.net. 27 JANAR 2020.

autoritetit të tij. Ai është udhëheqës i përrjetshëm. **4-Ekspozimi i madhësisë së komb-shtetit dhe i kontrollit total të shtetit.** Komb-shteti vihet mbi gjithçka; të gjitha aspektet e jetës politike, sociale, ekonomike, kulturore, shpirtërore janë subjekt i kontrollit të shteti. Individidi është i varur dhe i nënshtruar prej shtetit. Nuk lejohen organizata të pavarura, joqeveritare, ose ato vihen nën kontrollin e plotë të shtetit. Nuk ka kufizime ndaj ndërhyrjes qeveritare. Të tria hallkat e qeverisjes janë të shkruara në kuadrin e drejtimit njëpartiak e parti-shtet.

Një nga të mbijetuarit e Kampit të Përqëndrimit të Mauthausen-it, Beqir Xhepa kaloi nëpër kalvarin e dënimeve nga shteti komunist shqiptar kur ai iu kundërvu kultit të udhëheqësit si dhe ideologjisë marksiste mbi efektet e saj në ekonominë e vendit. Gjatë periudhës së Luftës familja e tij aty në qendër të Tiranës u bë një nga bazat kryesore ku strehoheshin krerët kryesorë të Partisë Komuniste Shqiptare dhe kryesisht Qemal Stafa, të cilin i ati, Hasan Stafa, ia kishte lënë amanet babait të tij, Ramazan Xhepës, (ish-ordinancë e Hasanit) dhe deri në 5 majin e vitit 1942, Beqiri shërbeu si korrier i Qemalit, gjë të cilën e vazhdoi edhe pas vrasjes së tij, duke marrë dhe dërguar letra të “shokëve” të tjerë të udhëheqjes komuniste. Dhe pikërisht teksa çonte një letër në Çetën e Pezës, ai u kap, u arrestua nga gjermanët dhe u internua në kampet naziste të shfarosjes, si në Mat’hauzen etj. Nga ku mundi të lirohej nga forcat anglo-amerikane dhe të kthehej në Shqipëri në vitin 1945, duke “lënë pa mend” familjen e tij dhe të afërmit, të cilët kishin pritur njerëz për “vdekjen e tij”. Por sikur të mos mjaftonin vuajtjet që kishte përjetuar në kampet naziste, Beqir Xhepa u arrestua dhe u burgos katër herë nga regjimi komunist i Tiranës, madje duke u torturuar në mënyrë çnjerëzore, gjëra të cilat ai nuk i kishte provuar as në kampin e Mat’hauzen-it.⁶⁹ Edhe pse i ntegruar më së miri në mekanizmat e shtetit komunist vetëm 6 vjet pasi kish ardhur në Shqipëri ai u burgos për të njohur tashmë torturat në burgjet komuniste. Persekucioni ndaj meje filloi kujton Beqir Xhepa që në vitin 1951, kur unë punoja në Zyrën Konsullore të Ministrisë së Jashtme. Aty më provokuan për bombën në ambasadën sovjetike dhe unë u thashë se ajo ishte bërë vetëm për të hequr qafe disa njerëz. Pas kësaj unë fillova punë në Ministrinë e Komunikacioneve dhe në vitin 1952, pa bërë fare lutje, Gogo Nushi më futi në Parti. Në vitin 1952, më propozuan të më fusnin në një zyrë sekrete në Ministrinë e Brendshme, por unë nuk pranova se e dija që ishte kurth për të më dënuar. Pas 7 muajsh, më 22 korrik 1953, më arrestuan duke dalë nga stadiumi. Kjo erdhi pas provokimit që më bëri Koloneli F. S. (Shef i Sigurimit të

⁶⁹Dashnor Kaloci. Beqir Xhepa: Torturat e hetuesisë nuk më ikishin bërë as në Mat’hauzen. Observatorii Kujtesës. 9 prill, 2018.

udhëheqjes), me të cilin u zumë fizikisht. Pasi më torturuan për 24 orë, më liruan se u ankua organizata ime e Partisë ku punoja. Pas kësaj unë u ankova me letra tek Enveri, Mehmeti, Fiqeretja dhe Prokurori i Përgjithshëm. Mehmeti më dha të drejtë dhe e transferoi F.S. në Kukës për dy vjet dhe H. Xh. që më rrahu bashkë me të, u dërgua në Gjirokastër.⁷⁰Përdejkja dhe nënimet e tij nuk do të ndaleshin aty, pavarësisht komunikimit të drejtë për së drejtë me udhëheqësit komunistë që ishin dhe arkitektët e terrorit të kuq në Shqipëri. Pasi mbarova universitetin për Histori-kujton Beqir Xhepa, unë punova në Kinostudio nga viti 1962 deri në 13 nëntor 1970 kur dhe u arrestova duke u akuzuar për agjitacion e propagandë dhe pas 17 muajsh hetuesi, u dënova me 8 vjet burg. E gjitha kjo erdhi pas takimi të rastësishëm që pata me Enverin kur ai bëri një vizitë në Kinostudio dhe më më pyeti: “Hë, ç’thotë Xani?” Unë i thashë se ai kishte vërejtje nga që i vinin katunarët dhe i kërkonin me ju ble bukë. Pas kësaj ai më tha që ato t’ia shkruaja me një letër. Në letrën që i bëra, unë ia shkruajta të gjitha duke i thënë se ishte fatkeqësi e madhe që fshatarët vinin për të kërkuar bukë në qytet. Atë letër që ia nisa me postë, ma quajtën anonime dhe më dënuan si përfundim me 6 vjet burg. Ndërsa kisha dy muajt e fundit të burgut në Ballsh, më 15 korrik 1976 më arrestuan përsëri me të njëjtën akuzë dhe gjykata e Fierit më solli për ekzaminim në Psikiatrinë e Tiranës. E gjitha ajo bëhej për të më nxjerrë mua të papërgjegjshëm, kjo ishte skemë e njohur. Por me gjithë insistimin tim për të mos ma dhënë atë diagnozë, Dr. Afrim Dangëllia ma firmosi atë duke më thënë që më mirë ashtu se të haja 10 vjet burg. Pas tetë muaj hetuesie më liruan në 25 nëntor 1977. Pas kësaj për disa vjet ma lanë me shit cigare në Rrugën e Kavajës dhe për herë të katërt më arrestuan më 28 nëntor 1986, me akuzën e agjitacion e propagandës. Dhe pas 6 muaj hetuesie, gjykata vendosi të më çonte përsëri në Psikiatri, nga ku unë u lirova më 16 tetor 1987. Ky arrestimi im erdhi pasi Sigurimi i Shtetit kishte futur në shtëpinë tonë të vjetër një person për të kontrolluar në se kisha letra anonime dhe për disa relike të Qemal Stafës që m’i kishte kërkuar Muzeu dhe unë nuk i jepja. Gjatë kontrollit nga Sigurimi, mua më gjetën një album dhe bust të Zogut si dhe disa antikuarë të vjetër e ikona. Po kështu mua më gjetën dhe 40 kg sheqer që m’i kishin sjellë njerëzit për vdekjen e babës. Ato m’i quajtën të vjedhura dhe mezi shpëtova nga ajo akuzë.⁷¹

Një rast tjetër i persekutimit të familjes së një të dënuari dhe viktime në kampin e Mauthausen-it është historia e inxhinier Kosta Mani, babait të regjisorit të shquar Pirro

⁷⁰DashnorKaloci. BeqirXhepa: Torturat e hetuesisë nuk m’ikishinbërë as në Mat’hauzen. ObservatoriiKujtesës. 9 prill, 2018.

⁷¹DashnorKaloci. BeqirXhepa: Torturat e hetuesisë nuk m’ikishinbërë as në Mat’hauzen. ObservatoriiKujtesës. 9 prill, 2018.

Manit. Tregon Pirro – Babai im, Kosta Mani ka lindur në Korçë. Si shumë korçarë, emigroi herët në Amerikë. Ka qenë rreth të katërbëdhjetave, kur mori rrugën e kurbetit përtej Atlantikut. Krahas punës vazhdoi edhe studimet. Ka studiuar në Institutin e famshëm M.I.T. të Bostonit, ku kishte studiuar edhe mjeshtri i madh i fotografisë, Gjon Mili, madje Kosta është diplomuar para mjeshtrit Mili. Është diplomuar për inxhinieri-arkitekturë. Ishte pjesë e Vatrës dhe idhtar I Fan S. Nolit. Si shumë idealistë të tjerë vatanë, e la Amerikën dhe u kthye në Shqipëri për të ringjallur vendin, për të bërë Shqipërinë. Kishte në xhep diplomën e inxhinierit. Sa i mungonin Shqipërisë inxhinierë të tillë si Kosta Mani!⁷² Pas kontributit të dhënë gjithandej nëpër vepra të ndryshme inxhinierike në Shqipëri, pushtimi italian dhe gjerman e gjen një antifashist por që mendon se mund ti kontribuoj vendit të vet duke u përfshirë në pushtetin egzekutiv që organizojnë gjermanët në vitin 1943. Në kohën e Asamblesë Kombëtare, në kohën e pushtimit gjerman, si deputet ishte pjesë e saj. Partizanët e qëlluan me top, duke e shpallur si “Asambleja tradhëtare”. Si shumë intelektualë të tjerë patriotë, Kostë Mani mendoi se Atdheut mund t’i shërbejë edhe nën pushtim. Por atë pjesëmarrje nuk ia falën komunistët. Umbloodh qarkori dhe e përjashtoi Kostën nga Këshilli. Ishte kohë e çmendur. Komunistët e akuzojnë, fashistët e arrestojnë. Edhe gjermanët, po ashtu, e arrestojnë si njeri të rrezikshëm. Me kë ishte Kosta Mani? Ishte me Shqipërinë. Arrestimi në fundin e dhjetorit 1943 nga gjermanët ishte fatal. Nazistët e syrgjynosën në kampin famëkeq të Mathauzenit. Pirro kujton se, nëna, e cila kishte marrë vesh lajmin e largimit nga burgu dhe internimin jashtë Shqipërisë, i kishte shkuar në burg dhe i kishte dhënë një xhaketë, që të mos kishte ftohtë, nën astarin e së cilës kish qepur, nën një arnë, 40 napolona flori. T’i ketë për çdo rast, pat menduar nëna. Pirro atë kohë ishte fëmijë, 12 vjeç. E ka në kujtesë pamjen e trishtë. Të burgosurit i hipën në kamionë dhe i nisën në mëngjes herët. Imazhi i mbeti në mendje. Në shtëpi prisnin në ankth ndonjë lajm. Shenja e fundit e komunikimit ishte një telegram, që ishte nisë nga Kosta. Ishin vetëm tri fjalë: “Jemi në Manastir”! Asnjë lajm tjetër.⁷³ Vetë jeta e regjisorit Pirro Mani kaloi përmes kalvarit të kujtesës dhe dëshirës për të mësuar më tepër për fatin e babait të vet. Pirro nuk hoqi dorë nga gjurmimet për të gjetur të dhëna për të atin, që më parë nuk mund t’i siguronte. Mësoi se Kosta Mani nuk ishte i vetëm, kur e nisën në kampin e vdekjes. Ishin më shumë se 200 të

⁷²Dalip Greca. KUJTËSË- INXHINIER KOSTA MANI, SHOQËRUESI I FAN S. NOLIT, U SHUA NË MATHAUZEN. Gazeta Dielli. 9 maj 2021.

⁷³Dalip Greca. KUJTËSË- INXHINIER KOSTA MANI, SHOQËRUESI I FAN S. NOLIT, U SHUA NË MATHAUZEN. Gazeta Dielli. 9 maj 2021.

burgosur. Një pjesë i dërguan në Prishtinë, pjesën tjetër në Mathauzen, ku i ra fati të shkonte baba Kosta. Përmes kërkimeve me shoqatat amerikane-hebraike, u arrit të sigurohen të dhënat e munguara, përfshirë dhe kohën e vdekjes, 27 Janar 1945, vendin e vrasjes dhe të dhëna të tjera...., madje, edhe numrin që mbante në uniformën e kampit të internimit.

...Lajmi fatal është mësuar pak muaj pas çlirimit të Shqipërisë. Në shtëpi kishte shkuar Spiro Koleka, që ka qenë ortak me Kostën në zyrën e projekteve dhe ndërtimeve “Stika”. Spiro ishte inxhinier i ri asokohe dhe bashkëpunoi me Kostën, edhe për të fituar eksperiencë. Ai solli lajmin fatal në shtëpinë e Kostë Manit. Familja shpalli zënë dhe e qau Kostën. U shpall dëshmor nga regjimi. Familjes iu dha edhe karta e dëshmorit, por drama e Kostë Manit nuk kishte të sosur. Ashtu si në kohën e italianëve, të gjermanëve dhe të komunistëve, secili e pa si armik. Pirro tregon: Më kujtohet se ka qenë një burrë me emrin Faruk, që jetonte në një barakë, diku aty ku ka qenë Ministria e Jashtme. Faruku ka qenë kampion boksi. Ai qe rritur në shtëpinë e Kosta Manit. Kujtoj se Faruku mbante dhe një pistoletë, ngaqë kishte qenë partizan...” Pirro kujton se po vinte Faruku me nxitim dhe i thotë: – Ç’po bën këtu? A e di ti se po demaskojnë gratë e familjes Mani?!

Shkoi me vrap. Agjitorët komunistë ngrinin zërin në kupë të qiellit për armikun imagjinar. Dhe armiku paskish qenë Kosta Mani, që na qenkish shpallë “dëshmor me biografi të keqe”, sepse paskish marrë pjesë në Asamblenë tradhëtare! Fronti Demokratik dhe partia nuk mund ta toleronin këtë tradhëti! Ultimatum i demaskimit ishte i rreptë: Familja armike Mani duhej të largohej brenda shtatë ditëve nga Tirana! Nisën reprezaljet. Pirron dhe motrën Marikën i hoqën nga puna, ndërsa motrën tjetër, Mirelën, e pezulluan nga shkolla. Ua hoqën dhe triskat. Ishte hapur fjala se Kosta nuk ishte vrasës dhe se punonte si agjent në një shërbim perëndimor!

Pirro thotë se e pagoi rëndë faturën. Por, siç duket, dikur u bindën se të gjitha këto ishin fantazira të sëmura komunistësh, sigurimsash, militantësh. Vetë ata e vërtetuan se Kosta ishte ekzekutuar në Mathauzen. Mirëpo hija e dyshimit mbeti pezull e kurrë nuk u trajtua më si dëshmor. Jo vetëm kaq, por Kostës nuk iu përmend emri asnjëherë si një nga inxhinierët e parë të Shqipërisë, diplomuar në Sh.B.A.. Pirro ruan një dokument që ka emrat e inxhinierëve që kanë kontribuar në Shqipëri, ku emri i parë është ai i Kosta Manit, pastaj i dy inxhinierëve italianë, i Gjadrit dhe i të tjerëve. Rehabilitimi i të birit të Kostës, Pirro Manit, ndodhi vonë.....⁷⁴

⁷⁴Dalip Greca. KUJTËSË- INXHINIER KOSTA MANI, SHOQËRUESI I FAN S. NOLIT, U SHUA NË MATHAUZEN. Gazeta Dielli. 9 maj 2021.

Emri i Kosta Mani ndodhet në Memorialin e Mauthausen-it në Austri dhe ai ka mbajtur numrin 100098. Rasti i tij si dhe disa të tjerëve dëshmon se të vdekurit apo të mbijetuarit e Kampit të Mathausen-it pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore kaluan në një rivlerësim përmes filtrave ideologjikë. Ndërsa në pamje të parë tmerret e kaluara nga të internuarit në Kampet e Përqëndrimit përmendeshin në çdo tekst të historisë zyrtare në një pjesë e ish të dënuarve ishin të detyruar të nënshtroheshin rregullave të totalitarizmit të ri.

Dekori ideologjik i diktaturës komuniste ndërtoi memorialin e shqiptarëve të rënë në Mauthausen përkrah memoriale dhe skulpturave të popujve të ndryshëm që u ndërtuan në Austri pas hapjes së debatit mbi të shkuarën naziste. Në një dokument të Memorialit në Mauthausen citohet kërkesa e qeverisë shqiptare për të ngritur një memorial përkujtimor është miratuar në 11 qershor 1968 nga ana e Ministrisë së Brendshme Federale të Austrisë ndërsa monumenti është inaguruar në 4 maj 1969.⁷⁵ Mauthausen u shpall një vend përkujtimor kombëtar në 1949. Muzeu u hap më 3 maj 1975, 30 vjet pas çlirimit të kampit. Një qendër vizitorësh u përrua në 2003. Monumenti që përkujton rezistencën shqiptare është punuar nga Odhise Paskali, Skulptor i Popullit. Ai përshkruan një ushtar gjerman të mundur, duke u nënshtuar nga krahu i fortë i një luftëtari shqiptar të rezistencës. Skulptura është e gdhëndur sipas kanoneve të Realizmit Socialist por autori ka arritur të pasqyrojë një personazh të tipit herkulian, ku forca dhe vullneti për të triumfuar duket si ndikim i skulpturave klasike të mposhtjes së luanit të Nemeut nga Herkuli. Që nga viti 1969 Memoriali shqiptar në Mauthausen është kthyer në një vend pelegrinazhi ku gjatë viteve të diktaturës komuniste organizoheshin vizita nga Komisioni i Mauthausen-it që ishte nën varësinë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Komiteti i Veteranëve. Në këtë kuadër sic dëshmojnë Enver Plepi dhe Abdulla Krutani, ish të dënuar në Kampin e Përqëndrimit të Mauthausen-it në Austri e kanë vizituar Memorialin disa herë. Monedha 1 Lek të vitit 1969, qëpërkujtojnë Ditën e Dëshmorëve të Atdheut me kurs ligjor, me vlerë 1 Lek, 5, 10, 20 dhe 50 qindarka, shtypur në Kinë, me rastin e 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, pjesa e përparme e saj paraqet gdhendjen e imazhit të skulpturës “Partizani Fitimtar”, realizuar nga Odhise Paskali dhe e vendosur në Mathausen, Austri, në vitin 1968. Pas rënies së diktaturës komuniste dhe debatit të gjerë për ngjarje e data të Luftës së Dytë Botërore duket se pati një zbehje të aktiviteteve kushtuar të internuarve shqiptarë në Mauthausen. Që prej vitit 2003,

⁷⁵Akten/BundesministeriumfürInneres/Lagergeschichte nach der Befreiung / Gedenk- und Mahnstätte Mauthausen

Aktenbestand des BundesministeriumfürInneres zur Errichtung eines albanischen Denkmals in der KZ-Gedenkstätte Mauthausen (genehmigt am 11.6.1968, enthüllt am 4.5.1969)

Ambasada shqiptare organizon një vizitë përkujtimore të shtunën e parë të majit. Në vitin 2000 , Kryeministri shqiptar Ilir Meta shpalli 74 veta që kishin vdekur në Kampin e Mauthausen-it në Austri dëshmorë të atdheut. Lista e shqiptarëve që kanë vdekur në kampin e Mathauzenit(sipas botimit të gazetës “Tirana Observer”)⁷⁶

Nr.personal	Emri	Datëlindja
99825	Athanas Babe	10.04.1907
99950	Andro Gerveni	01.01.1910
99769	Abdullah Kinetani	1926
99816	Ajaz Arifi	1911
99398	Anastas Stavro	1924
99084	Ahile Lito	01.06.1916
99...	Bedri Agalliu	01.04.1916
99771	Besim Liku	01.03.1920
100075	Çako Lamani	1888
100436	Dervish Troka	1888
100234	Ded Papa	19.04.1884
99886	Sofokli Dhimitriadhi	06.01.1910
99938	Estref Fiaq	19.06.1910
99900	Fejza Dino	25.10.1910
99833	Gani Begosali	16.05.1908
100517	Georgi Cin	1922

⁷⁶Andrea Petromilo. Kujtesë e hidhurMat’hauzen. BotimetYmeraj, Vlorë, 2019, fq125 – 127.

99765	Hajtedin Hazdinaj	1900
99828	Hazbi Bani	15.12.1916
100038	Habib Koka	1902
100431	Halem Telfaj	1902
99806	Halil Aliti	1895
99966	Ibrahim Gunbardhi	22.06.1897
99885	Istref Dekollari	15.10.1918
00497	Jakup Telfaj	1918
99764	Jani Goda	26.03.1900
99807	Fadil Alushi	05.02.1919
100098	Kosta Mani	15.05.1892
100358	Kostandin Sernikiç	01.01.1921
99838	Lefter Bezhani	07.06.1886
100187	Musten Gunbardhi	04.07.1886
99863	Miho Çiko	07.09.1912
100352	Mihal Shyti	01.09.1894
100355	Moikom Shyti	18.04.1900
100189	Naço Siko	16.11.1880
99862	Nikolla Çika	18.06.1903

100232	Niko Papalilo	13.05.1907
100226	Lilo Palla	18.01.1893
99798	Ilija Vimo	03.03.1910
100233	Perikli Papingji	1898
99861	Qazim Çakërri	05.03.1897
100186	Qemal Muhedari	05.02.1908
••••••••	Ramazan Berberaj	03.04.1905
100313	Ramazan Armeni	25.02.1897
100460	Rushit Vërzhezha	18.10.1906
100433	Rexhep Toto	13.09.1895
100138	Myzafer Velaj	13.03.1910
100190	Nazif Spani	12.02.1896
99786	Rapo Ruçi	1898
100330	Rukije Sulejmani	15.03.1920
100333	Refat Sedrioviç	02.01.1914

100295	Rahman Hysa	08.01.1891
100184	Refit Mustafaj	15.05.1880
100332	Farudin Rustemi	10.10.1917
100476	Skënder Vrenaraj	12.12.1912
100350	Selfo Shebaj	1899
99790	Sulejman Seferi	07.07.1916
99832	Selim Begaj	02.12.1897
99894	Sofoldi Dimi	02.05.1914
100031	Seit Qemali	21.02.1881
100032	Shezai Qemali	21.12.1903
99791	Shefget Suli	1926
99905	Shahin Alia	1901
100432	Shyqyri Tare	1899
100522	Zoga Falre	15.09.1895
100268	Taqi Poliçani	02.10.1896
100499	Vangjel Xhema	1926

100029	Thoma Karagjozi	1912
99823	Qerim Asimi	20.01.1911
99955	Kristofor Gjyli	15.07.1911
99788	Stefan Sotiri	01.06.1924
99952	Nasim Gjani	07.04.1904
100013	Tahsim Jonuzi	10.03.1912

Bazuar në ligjin nr. 109/2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi: Kreu I, neni 4 “Familje e Dëshmorit të atdheut është familja që i ka dhënë Shqipërisë një apo më shumë persona të shpallur “Dëshmor i atdheut”. Kreu II, neni 5 thotë: “Dëshmorë të atdheut shpallen ose u njihet statusi, si i tillë...[pika] dh) Shtetasit shqiptarë, të cilët janë ekzekutuar apo kanë vdekur në burgjet dhe kampet nazifashiste të përqëndrimit apo kanë vdekur si pasojë e plagëve apo sëmundjeve të ndryshme të marra në këto vende deri më 9 maj 1945”. Në këtë drejtim kujtesa institucionale nuk ka munguar por në të njëjtën kohë bashkëpunimi me komunitetin e pasardhësve të viktimave ka sjellë në pah dhe ndërtimin e memoriale të ndryshme në Shqipëri e përkatësisht në Vlorë. Me rastin e 75 vjetorit të Çlirimit të ish-kampit të përqëndrimit Mat’hauzen, në Vlorë, është ngritur Memoriali i Kujtesës së Dëshmorëve të Mat’hauzenit përkarshi bashkisë së qytetit të Vlorës, atje ku në vitet e LANÇ ishte burgu, nga i nisën drejt kampit të përqëndrimit Mat’hauzen djemtë e Vlorës pas fushatës së arrestimeve nga nazistët.

Përfundime

Kujtesa historike është një proces që mund të punojë në dy drejtime. Drejtimi i parë është ai përkujtimor që është dhe varianti më i përhapur dhe që nënkupton se vlera, ide dhe personazhe i shërbejnë shoqërisë vazhdimisht për të mbajtur gjallë memoriën kolektive dhe gjykimin mbi ngjarje që kanë shenjuar kohën dhe i dyti është drejtimi mohues që është variant më pak i përhapur dhe që nënkupton që ngjarje, personazhe apo dhe vlera “harrohen”

sërisht për ti shërbyer harresës së shoqërisë mbi ngjarje dhe histori në të shkuarën. Një rast i tillë është p.sh ai i Zvicrës, ku lufta e konfederatave në 1846 harrohet dhe nuk përmendet për ti mëshuar më fort identitetit zviceran të të tre kantoneve. Në Shqipëri për shumë arsye që kanë të bëjnë me rastin specifik të saj në historinë e Ballkanit por edhe pse zakonisht modelet janë marrë të gatshme nga jashtë, është përqafuar drejtimi i parë , ndaj dhe njerëzit dhe shoqëria janë shumë të ndjeshëm ndaj çdo mohimi apo denigrimi të atyre që janë pranuar prej kohësh si vlera të mirëfillta historike dhe personazhe të rëndësishëm që kanë mbizotëruar historinë e vendit. Sigurisht që në këtë qasje shqiptare ka vend dhe për korrigjim apo dhe një ç'mitizim që shpesh herë është vënë re në trajtimin e çështjeve dhe ngjarjeve të ndryshme historike, por pavarësisht faktit që kohët e fundit ka shumë përpjekje për rivlerësim apo rebalancim të këtyre vlerave duke u përpjekur për të rishkruar historinë, besoj se gjithsecili nuk mund të bjerë dakord me forma ekstreme të përdhosjes së atyre që janë nderuar dhe do të vazhdojnë të nderohen nga pjesa më e madhe e shqiptarëve si baballarët e kombit. Qasja ka të bëjë më tepër me përmbajtjen sesa me harresën kinsë të pafajshme të formave të totalitarizmit të djathtë, arresitimeve dhe burgosjeve të njerëzve të pafajshëm gjatë pushtimit nazist në Shqipëri.

Krimet e nazizmit dhe komunizmit kanë nevojë të evidentohen dhe të vihen në një rrafsh krahasues me vendet e tjera të ish Lindjes Komuniste. Debati duhet të udhëhiqet nga akademikë, historianë, psikologë, juristë, sociologë për të nxjerrë jo vetëm përgjegjësitë ligjore mbi ushtrimin e dhunës por edhe ato morale. Është e rëndësishme në këtë proces që dalin në pah përgjegjësia ligjore e atyre që kanë kryer krime të dënueshme nga ligji. Në vazhdim përgjegjësia politike e atyre që e kanë mbështetur politikisht ato regjime totalitare. E së fundi, përgjegjësia morale e atyre që kanë ekzekutuar urdhra apo e kanë mbështetur atë regjim, duke u justifikuar se s'kanë pasur ç'të bëjnë.

Të vdekurit dhe të gjallët që vuajtën në Kampin e Mauthausenit patën nevojë për një drejtësi tranzicionale pas përfundimit të Luftë së Dytë Botërore. Në bazë të ligjit për shpërblimin e veteranëve të luftës, ish të dënuarit në kampet e përqëndrimit përfitonin një lloj si pjesëmarrësit e tjerë në rezistencë një shpërblim monetar që shkonte në shumën 100 lekë në muaj. Por asnjë lloj shpërblimi i pa shoqëruar me masa të tjera për rikuperimin e tyre shpirtëror nuk mund të plotësonte thyerjen dhe depersonalizimin e tyre gjatë viteve të internimit. Fusha e drejtësisë transitore është sa e ndjeshme, aq edhe ende e paeksploruar. Nga ana tjetër, është gjithashtu mjaft e larmishme, duke qenë se regjimet e kaluaramund të kenë qenë naziste, fashiste, komuniste, ose nëse do i gruponim bashkëdo t'i quanim regjime

totalitare. Por, regjime të tjera me natyrë autoritare janë të natyrës sulltanistike, ose të tipit junta ushtarake ose post-totalitare, që gjithsesi kanë pasur pjesën e tyre të krimeve individuale dhe kolektive dhe për të cilat drejtësiatransitore ka funksionuar në forma të ndryshme të testuara empirikisht. Qysh nëditët e para, në fushën teorike, por me implikime praktike, të drejtësisë transitore,ka pasur debate mes ndëshkuesve, të cilët argumentojnë ndjekjen penale passhkeljeve masive të të drejtave (p.sh. Drumbl, 2007), dhe restauruesve, të cilëtmbështeten kryesisht në mënyra “të buta” të marrëdhënies me të kaluarën, siçështë tregimi i së vërtetës (Teitel, etj. 2002; Eiebelhaus-Brahm 2010). Megjithatë,të tjerë kanë shtuar gjithashtu koncepte dëmshpërblese të drejtësisë (Muddell &Haëkins, 2018).⁷⁷Defashistizimi i Shqipërisë ndodhi që në hapat e parë të ndërtimit të shtetit komunist shqiptar por si në çdo regjim totalitar ai u shoqërua dhe me akuza dhe kundërshti mes rolit të organizuesve të vërtetë të arrestimeve dhe deportimeve drejt Mauthausen-it dhe gjithë atyre që luajtën një rol përgatitor dhe heshtës gjatë këtyre arrestimeve. Udhëheqësit e shtetit shpesh janë përgjegjës për hartimin e politikave që kanë në fokus hakmarrjen e bazuar në ligj, si për shembull ndjekjet penale. Ndërsa njëpjesë tjetër favorizon mekanizmat indirekt përmes mekanizmave restaurues, sipër shembull komisionet e së vërtetës . Në Shqipëri u ndoq rruga e parë ku jo shpesh herë bazuar dhe mbi përvojat staliniste drakoniane u akuzuan njerëz që ishin vetëm leva të pushtetit për të përligjur represionet ndaj shtresës kundërshtare komuniste në Shqipëri. Lufta jonë kundër nazifashizmit përfshiu shumë njerëz, fate njerëzore e personazhe që do të shenjonin historinë e mëvonshme 50-vjeçare së Shqipërisë, por në asnjë rast korruptimi i idealeve të atyre që morën pjesë në luftë nga ata që volën frutat e fitores duke u shndërruar në udhëheqës që shkelën mbi idealet e ëndrrat e shokëve të tyre në luftë, nuk duhet ngatërruar duke përbaltur protagonistët dhe njerëzit e thjeshtë që vunë gjakun dhe sakrificat e tyre në shërbim të atdheut. Lufta jonë, përveçse një luftë çlirimtare, është dhe një sfidë për shqiptarët e sotëm për të parë të vërtetën dhe të shkuarën drejtpërdrejtë në sy, pa komplekse për të shkuarën dhe me një tharm dinjiteti njerëzor për të shkruar historinë moderne të Shqipërisë, larg llogoreve të hapura që në frontin e luftës dhe me një gjithëpërfshirje dhe përfaqësim të të gjithë atyre që kontribuuan sado pak në mbarëvajtjen dhe fitoren mbi fashizmin. Respektimi i viktimave dhe dëshmitë e mbledhura nga pasardhësit e kampit të Përqëndrimit të Mauthausen-it janë dëshmi referenciale që dëshmojnë triumfin dhe nganjëllimin e dinjitetit njerëzor mbi banalitetin e së keqes.

Bibliografia:

⁷⁷Iilir Kalemaj. Lustracioni në Shqipëri: E shkuara dhe e ardhmja. fq 9

Akademia e Shkencave, *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll IV, Toena, Tiranë, 2009

Andrea Petromilo. Kujtesë e hidhur Mat'hauzen. Botimet Ymeraj, Vlorë, 2019.

AQSH, Bobina T 314-661 me mikrofilm 000947. Dokumentet gjermane të kohës së luftës.

Bernd J. Fischer, *Shqipëria gjatë luftës 1939-1944*, Çabej, Tiranë.

Dalip Greca. KUJTËSË- INXHINIER KOSTA MANI, SHOQËRUESI I FAN S. NOLIT, U SHUA NË MATHAUZEN. Gazeta Dielli. 9 maj 2021.

Dashnor Kaloci. Beqir Xhepa: Torturat e hetuesisë nuk m'i kishin bërë as në Mat'hauzen. Observatori i Kujtesës. 9 prill, 2018.

Dervish Kondi. Katër kuçiotët e Mat'hauzenit. Gazeta Telegraf 16 Shtator, 2013.

Erik Hobsbawm. Epoka e ekstremeve. Çabej, Tiranë, 1994.

Fatos Baxhaku, Afer dhe larg. Rrëfimet e durrsakut, që mbijetoi në Mauthausen. G. Shqip, 08/04/2007.

Gazeta Tirana Observer, "Ja kush janë 48 shqiptaretqevdiqen ne kampin e Mathauzen, 2009.

Hannah Arendt, *Origjinat e totalitarizmit*, Prishtinë, Dijs, 2002.

Haunschmied, Mills, Witzany-Durda (2008), pp. 172–175; Geoffrey R. Walden (2 July 2000). "Gusen Concentration Camp / Project B-8 "Bergkristall" Tunnel System". The Third Reich in Ruins.

Henry Kissinger, *Diplomacia*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1999.

Historia e Popullit Shqiptar, vëll. IV, Tiranë: 2008

<https://www.mauthausen-memorial.org>

Illir Kalemaj. Lustracioni në Shqipëri: E shkuara dhe e ardhmja. fq 9

Jonida Hitovezi. Abdulla Krutani, i mbijetuari i fundit i "Mauthausen" që i shpëtoi krematoriumit. Dritare.net. 27 JANAR 2020.

KristoFrashëri, *Histori e Qytetimit Shqiptar*, Tiranë, 2008.

Leon Poliakov, Totalitarizma e Shekullit XX, Përpjekja, Tiranë, 2010.

Marenglen Kasmi.

MEPJ ARKIV, VITI 1948, DOSJA:74.

Monika Stafa. Në Mathausen, historia dëshmon. E HËNË 18 KORRIK 2016, 15:03. DRITARE.NET

Paskal Milo, *Udhëkryqet shqiptaro-gjermane*, Toena, Tiranë, 2016.

Stanisław Dobosiewicz (1977). Mauthausen/Gusen; obóz zagłady [Mauthausen/Gusen; the Camp of Doom]. Warsaw: Ministry of National Defence Press.

Uolltër Lakër, *Europa në Kohën Tonë 1945-1992*, Dituria, Tiranë: 2003.

Viktor E. Frankl. "Në kërkim të kuptimit të jetës" Botimet "Gumeni", Tiranë, 2007.

William L. Shirer. Ngritja dhe rënia e Rajhut të Tretw. Një histori e Gjermanisw Naziste. Vëllimi II, Onufri, Tiranë, 2004.